



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIV i botimit, nr. 155, Shtator 2016

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Shën Tereza



Data 4 shtator 2016 do të mbetet e gdhundur në kujtesën e shqiptarëve si dita e shenjtërimit të shqiptares më të njohur dhe më të respektuar në botë, bamirëses së madhe Nënës Terezë

**Kruga e Dukagjinit,
nuk është thjeshtë
një mision, por
një detyrë e
pashmangshme për
secilin dukagjinas...**

Në muajin gusht, ishte në Shkodër biznesmeni Ndue Ftoni. Me nismën e tij, me datën 18 të këtij muaji u bë një takim me Kryetaren e Qarkut Shkodër, zonjën Greta Bardeli. Në këtë takim ishte sekretari i komisionit të kësaj rruge, Tome Ndoka, anëtari i komisionit Ndue Ftoni, Ndue Marashi, Gjon Shkambi dhe kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj. Nga ana e Këshillit të Qarkut ishte dhe Sekretari i këtij Këshilli, zoti Gjon Marku.



**KAMPIONI, KAPTENI DHE
MESHIRI I MADHNA IA!**

LIN SHLLAKU, SHQIPTARI I VETËM QE
THIRRI SHENI NË PËRFAQËSUESËN E
EVROPËS



Kruga e Dukagjinit, nuk është thjeshtë një mision, por një detyrë e pashmangshme për secilin dukagjinas ...

Në muajin gusht, ishte në Shkodër biznesmeni Ndue Ftoni. Me nismën e tij, me datën 18 të këtij muaji u bë një takim me Kryetaren e Qarkut Shkodër, zonjën Greta Bardeli. Në këtë takim ishte sekretari i komisionit të kësaj rruge, Tome Ndoka, anëtar i komisionit Ndue Ftoni, Ndue Marashi, Gjon Shkambi dhe kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj. Nga ana e Këshillit të Qarkut ishte dhe Sekretari I këtij Këshilli, zoti Gjon Marku.

Takimi u përqendrua në marrjen e mbështetjes së këtij institucioni vendor dhe nëpërmjet tij, të behej i njohur deri në Qeveri, se bashkësia e Dukagjinit kërkon të filloi rindërtimin e rrugës së Dukagjinit: Prekal-Kir-Shosh-Breglumi-Theth-Qafe T'thore, sepse infrastruktura e rrugës është mjaft e shkatërruar dhe pa te, nuk mund të ketë zhvillim kjo zone dhe banoret e saj. Nuk mund të shfrytëzohen resurset njerëzore, turistike, historike e prodhimet e shumta të kësaj zone pa rindërtimin e infrastrukturës rrugore. Ndue Ftoni, u ndal dhe premtoi Kryetares gatishmërinë e tij dhe të bashkësisë dukagjinase në Miçigan, në Nju-Jork e në shtet e tjara të SHBA, që do të kontribuojnë në rindërtimin e saj.

Kryetarja e Këshillit të Qarkut shprehu ndjeshmërinë e saj ndaj kësaj gjendjeje shkatërruese të kësaj rruge dhe premtoi mbështetjen e institucionit që drejton, do të bëj gjitha përpjekjet për të sensibilizuar deri në institucionet më të larta të shtetit, për të marre në dore rindërtimin e saj.

Me 22 gusht, u bë takimi me Kryetaren e Bashkisë, zonja Voltana Ademi. Ishin prezent Petrit Arra-Administratori i Njësisë Administrative- Shale dhe në të njëjtën kohe-Kryetari i Komisionit për rrugën e Dukagjinit; Tome Ndoka-Sekretari i komisionit; Ndue Ftoni-anëtar i komisionit; kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj dhe veprimtarët Gjon Shtegu e Ndue Shytani.

Kryetarja e Bashkisë, pasi dëgjoi me vëmendje Kryetarin e komisionit, anëtarin e komisionit Ndue Ftoni, sekretarin e komisionit dhe të tjerët, mori fjalën dhe tha: "Bashkia Shkodër e mbështet nismën tuaj deri në institucionet më të larta të shtetit. Bashkia ka bërë një projekt, i cili është miratuar dhe nga Këshilli i Saj, për



Kryetarja e Këshillit të Qarkut Shkodër, zonja Greta Bardeli
Biznesmeni dukagjinas, në Miçigan, Ndue Ftoni



Prefekti I Qarkut Shkodër, zoti Pavlin Radovani, anëtar i komisionit të rrugës së Dukagjinit, Ndue Ftoni e Ndue Marashi

të mirëmbajtur atë rruge, jo thjeshtë për të rimbushur gropat e saj, por për të rindërtuar anësoret e rrugës, mbështetëset e deri ndonjë ure, të cilat do të jene pjese e rindërtimit të kësaj rruge.

Me datën 25 gusht u bë takimi edhe me Institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, me Prefektin, zotin Pavlin Radovani. Në këtë takim ishin anëtar i komisionit Ndue Ftoni dhe Ndue Marashi. Prefekti tha: Institucioni i Pre-

fturës dhe unë, edhe në detyrën time e mbështesim nismën tuaj, se nisma e juaj është e drejtë, është shqetësuese, është konkrete në shërbim të një zone, në shërbim të banoreve të saj, të zonës së Dukagjinit. Ne, nuk do të ndalemi deri në institucionet më të larta të shtetit për të filluar puna sa më pare dhe për të vijuar puna deri në rindërtimin e plotë të kësaj rruge.

Në këto takime Komisioni i rrugës së Dukagjinit për mbledhjen e fondeve dhe sensibilizimin gjendjes së saj, marrjen e masave nga strukturat e Qeverisë e të Shtetit Shqiptar për rindërtimin e saj, mori mbështetjen e Strukturave të pushtetit vendor dhe nga këto institucione ju beri thirrje gjithë biznesmenëve, gjithë bashkësisë dukagjinase kudo ndodhur që të bëhet pjesë e rindërtimit të kësaj rruge, me moton "Fëmija që nuk qan, nuk pi qumështin e nenës!"

Në këto takime ishin dhe mediat në Qarkun e Shkodrës, të cilat dhanë më shumë ndjesi informacionin sensibilizues për kërkesën e bash-



Takim me Kryetaren e Bashkisë, znj. Voltana Ademi

kësisë dukagjinase, nëpërmjet komisionit të saj, të cilat i falënderojmë për punën që bëjnë. Mirënjohje.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" duke qenë pjesë e kësaj bashkësie, në shërbim të kësaj bashkësie, me datën 19 shtator 2016, me numër 1262, i ka dërguar një letër Kryeministrit të, zotit Edi Rama, me këtë përmbajtje:

Ju bëjmë me dije se, Drejtorit Ekzekutiv të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me nr. 1129, date 7 korrik 2014, i kemi bërë një kërkesë për takim pune dhe nuk kemi takuar.

Zoti Kryeministër, me këtë përmbajtje, ju kemi bere një kërkesë Ju, me nr. 1133,

Inderuar Zoti Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë!
Jam Ndue Sanaj, Kryetari i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", me qendër në Shkodër.

Ju kemi shqetësuar dhe përsëri po ju shqetësojmë për një problem mjaft serioz, për zonën e Dukagjinit e banorët e tij, dukagjinast, të cilët në mjaft drejtime, për të jetuarit në kushte normale, por në veçanti për infrastrukturën rrugore, janë lenë e po lihen krejt pas dore, janë të persekutuar tërësisht në këto 25-26 vite.

Rruga e makinës Prekal-Kir-Shosh-Breglumi-Theth-Qafe T'thore, tashmë, kjo

rrugë nuk është më rrugë, që te të çoi në bukuritë e Alpeve Shqiptare, që qendra e tyre është zona e Dukagjinit, por është bërë përfundimisht një rruge që të hedh në humnerat e frikshme, në të cilat gjaku ka ngelur i njomë nga aksidentet automobilistike të një pas njëshme.

Aksidenti i fundit e ka çuar numrin në 54 humbje jete njerëzish në pak vite ...

Në përpjekjet e bëra për tu marre në dore kjo rruge e kësaj zone, duke u ndërtuar pjesë-pjesë, në pjesën Prekal-Kir u bë e mundur të fillonte puna në muajin shtator 2013 që u hap prokurimi për ndërtimin saj. Të gjithë u habitëm, kur u

pa, se do të merrte një zgjidhje, gjithçka shkoi drejt heshtjes, drejtë harresës dhe asgjë nuk u duk kund, qofte dhe një dritare sa do e vogël në horizontin e pafund të mundësive. Rruga është po ajo, historia e aksidenteve vijon, por vijon dhe heshtja e mos shqetësimi i asnjë strukture kompetente, edhe nga Ju, që shpresat ishin e janë të jashtëzakonshme, për të zgjedhur këtë problem mjaft shqetësues dhe jetik për banoret e kësaj zone, për turistët, për lëvizjen e njerëzve në tërësi për të shijuar bukuritë e Alpeve tona ...

Në emër të atyre jetëve të humbura, në emër të familjarëve të atyre vikti-

NJË VËZHGM

Ne, dukagjinasi e Shkodrës jo në pak raste themi: Ku është Dukagjini? Nuk po merret kush me Dukagjinin! Dukagjini është lenë pas dore! Dukagjini e dukagjinasi persekutohen në çdo kohë! E të tjera shprehje e mendime që thuhën me këtë ide, here pas here në kafe, në takime tavoline, në dasma apo në mort dhe ndonjë rast edhe në media. Të gjitha janë të drejta! Po, ku është Dukagjini?! Po, kush po merret me Dukagjinin?! Po, Dukagjini është lenë pas dore! Po, Dukagjini e banoret e tij, dukagjinasi janë persekutuar e çdo kohë dhe po vijojnë të persekutohen!

Pra, në këtë vëzhgim nuk dua të analizoj asnjëherë prej këtyre mendimeve, sepse dua të shtroj një pyetje të thjeshtë: Ne, apo e persekutojmë Dukagjinin? Ne, apo tregohemi jo në pak raste hipokrit me emrin DUKAGJIN, duke e përdorur vend e pa vend? Ne, apo tregohemi jo në pak raste deri racist nder-veti? Në analizën time, them: PO!

Lexues të gazetës "Dukagjini", dukagjinasi shikoni këtë foto! Kjo foto është në shtetin e Miçiganit, në Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ndue Ftoni, në Miçigan, njërin nga bizneset e tij e ka pagëzuar me emrin "Dukagjini"; ndërsa në qytetin e Shkodrës nuk ka një biznes, me pronar Dukagjinasi, që ta ketë pagëzuar me emrin "Dukagjini".

Mendoj, se nuk ka nevojë për koment, por se cili dukagjinasi duhet të vlerësojë këtë vëzhgim ...



date 4 shtator 2014. Për këtë, nga Drejtoria i Marrëdhënieve me Qytetarin, zonja Ana Rafti, me shkresë nr. 6490, date 17/ 09 / 2014, jemi vene në dijeni se, kërkesa e jone i është drejtuar: Ministrisë të Brendshme, zotit Saimir Tahirit; ish Ministrisë të Transportit dhe Infrastruktura, zotit Edmond Haxhinasto ... Po, me kërkesë nr. 1158, date 19 mars 2015 ju jemi drejtuar përsëri Ju, me një kërkesë tjetër për shqetësimin tone, megjithatë nga kërkesa e pare e deri tani u bënë 25 muaj dhe nuk kemi marre asnjë përgjigje ... Me sa dimë, ka kaluar çdo afat për të na dhënë një përgjigje ...

Me keqardhje vëmë re se, ndërtimi i kësaj rruge nuk është vu në plan as për vitin 2016-2017 ...

Ky qëndrim jo vetëm që nuk është i drejtë, por na le një shije jo të mirë, çka do të thotë bjeri i forti të ligut ...

Zoti Kryeministër, këto ditë ishit në Shkodër, bëtë mirë që vizitove Kelmendin, Gruemirën, Spitalin Rajonal, Vau-Dejës, por nuk bëtë mirë, që nuk shkove

deri në Kir, që nuk shkove deri në Breglumi e të udhëtoje në rrugën Theth-Qafe T'thore – Koplik dhe prej andej të udhëtoje në drejtim të Kelmendit, ashtu siç shkove deri në Gjegjan të Pukës, sepse në qoftë se deri në Gjegjan të është lodhur mezi, po të kishe shkuar në rrugën që të cilësova më sipër, do të ishit trembur dhe vonë do te të dilte ...

Zoti Kryeministër, rruga nuk ka brenda as të majte e as të djathtë, ajo është rrugë me gurë e me dhera e nesër me asfalt, që i shërben zhvillimit të zonës së Dukagjinit, i shërben zhvillimit e emancipimit të banorëve të tij. Mos qofte e thënë, se nuk shkua në atë zone, nuk kaluat në atë rrugë, sepse Bashkinë e Shkodrës e drejton Voltana Ademi, përfaqësuese e PD-se. Nuk do ta thosha këtë, në qoftë se do të kishit kaluar nga e cilësova më sipër.

Zoti Kryeministër, me 17 qershor 2016, u mblodhën dhjetëra banorë nga Dukagjini, në mjediset e bar restorant "Blini" në qytet e Shkodrës, me temë:

Vatikani fton djalin nga Lotajt ...

Shenjtërimi i Nene Terezës ishte një gëzim i madh për mbare kombin shqiptar. Të gjithë shqiptaret brenda e jashtë kufijve u ndien krenar, sepse Nene Tereza është shenjtoria e Pare shqiptare. Në këtë ngjarje madhore morën pjesë shqiptar e të huaj nga e gjithë Bota të ftuar nga Selia e Shenjte, në Vatikan. Një nder këta ishte edhe Gojvalin Gjellaj, i datëlindjes 1969 dhe i lindur në fshatin Lotaj-krahine e Shalës, i cili udhëtoi nga SHBA. Aty, përfaqësoi banoret e fshatit Lotaj, pse jo edhe më gjere, Dukagjinin, në këtë ngjarje me përmasa historike për Nacionalitetin Shqiptar.

Gjovalini mund të themi me bindje të plote, se ishte përfaqësuesi më dinjitoz për fshatin. Ai dha një kontribut në mundësimin e përgatitjes e dhënies së koncertit artistik të datës 3 shtator 2016. Ai është një humanist i vërtete. Pjesëmarrja e Gjovalinit në Meshën e Madhe të Shenjtërimin të Nene Terezës, i drejtuar nga Papa Francesku, është nder jo vetëm për fshatin Lotaj, por edhe për gjithë Dukagjinin. Gjovalini, pasi mbaroi shkollën e mesme, punoi në fshat, në detyra të ndryshme, në të cilat tregoi pjekuri e vullnet në pune, duke fituar respektin e gjithë banoreve të fshatit. Në moshe fare të re, Gjovalini shkroi vëllimin me poezi, të titulluar "Ikja në pranverë", me të cilin pati mjaft suksese.

Gjovalini, në vitin 1996 emigroi në SHBA, në Miçigan. Atje punoi shume. Pas një



pune të palodhur, i kudo gjendur, me shume sakrifica arriti të behej një biznesmen i suksesshëm. Ai, asnjëherë nuk e harroi vendlindjen e tij. Ndihej shume njerëz në nevojë me thjeshtësi e zemërgjerësi të radhe, duke treguar virtyte të larta njerëzore e duke përfaqësuar më së miri traditat e të pareve të tij.

Gjovalini ka disa vite që është mundësor i rregullt i koncertit tradicional të Ansambllit Folklorik "TREVA" të Dukagjinit dhe ka dhënë kontributin kryesor për botimin e librit historik të fshatit Lotaj, që do të dali së shpejti nga shtëpisë botuese "Fiorentia".

I shkruaj këto rreshta në shenjë falënderimi, respekti e mirënjohje për kontributin që jep ky dukagjinasi në shërbim të bashkëkombësve të tij. I urojme jete të gjate, faqe bardhe dhe suksese në punën e tij.

Zef Lulash Sokoli, Lotaj

"**Të gjithë për rrugën e Dukagjinit!**". Ishte një mbledhje e jashtëzakonshme, u bë një diskutim shumë popullor për një problem konkret për zonën e Dukagjinit, siç është infrastruktura rrugore. E morën fjalën shumë banorë, të cilët vunë në dukje rëndësinë e rindërtimit të kësaj rruge, domosdoshmëri për zhvillimin e gjithë zonës, e gjithë jetës së banorëve të saj. Disa e quajtën edhe rruga e vdekjes, pasi vetëm në një segment prej 7 km të kësaj rruge kanë vdekur nga aksidentet 54 vetë, ndonjë edhe i huaj. ...

Zoti Kryeministër, në qoftë se ju, nuk keni mundësi kohe për të bere një vizite në këtë zonë, caktoje Zëvendësin tuaj, Niko Peleshin, të vije në Shkodër e të marrë përsipër të kalojë në atë zonë, në atë rrugë, do ta shoqërojnë autoritet kryesore të vendit me shumë dinjitet, e besoj, se me mend të tjera ka për të raportuar e propozuar masa për zhvillimin e kësaj zone e për banoret e tij.

I nderuar Zoti Kryeministër, e përsërisë, zona e Dukagjinit dhe dukagjinasi janë

pjesë e Shqipërisë dhe jo me më pak kontribute se zonat e tjera te të gjithë Shqipërisë në themelet e kësaj Nënëloke që e ka emrin Shqipëri këndeje e andej kufijve administrativ të shqiptarisë. Këtë vit më ka takuar rasti të shkoje në gjithë hapësirat Shqiptare, që nga Saranda e deri në Mitrovicë dhe askund nuk pashe një infrastrukturë rrugore më të shkatërruar, po i themi rrugë të shkatërruar për ta zbutë pak, por në fakt ajo është kthyer në një trase!?

Pse???

Ju lutem, hape adresën www.shoqatadukagjini.com, rubrikën "Gazeta", nr. 152 dhe lexoni për këtë rrugë.

Mbetemi në shpresën dhe në besimin se, Ju i nderuar zoti Kryeministër do ta merrni në dore këtë shqetësim me seriozitetin maksimal, në interes të zonës së Dukagjinit dhe banoreve të tij.

**NDUE SANAJ,
KRYETARI**

KAMPIONI, KAPITENI DHE MJESHTRI I MADHINA LA!

LIN SHLLAKU, SHQIPTARI I VETËM QE THIRRI SHENI NË PËRFAQËSUESËN E EVROPËS (PËRSE NUK SHKOI I PA FATI)

Në Fushe Arrëz rreth 24-25 gusht u ktheva vone nga një shërbimi i largët nga Fierza. Kisha nevojë për një gjumë të thelle pas 200 km udhe në makine e 5-6 ore lëvizje në terren këmbësore.

Gjumini ma shtyri dhe ma çrregulloi lajmi që pashe në titra për vdekjen e Kapitenit të "Partizanit" e Kombëtares "Mjeshtër të Madh", Lin Shllaku.

U trishtova nga ky lajm i keq. Humbja e një futbollisti kaq të madh krijon gjithmonë boshllëk. Humbja një kapiteni legjende, e një njeriu që përket historisë dhe të një miku të pa harruar krijon një zbrazësi që nuk përmbushet, por që shpërthen në kujtime të dhimbshme.

Lin Shllaku lindi me 12 korrik 1938 në Shkodër. Ishte djali i Kole Shllakut nga Palajt e Shllakut dhe nipi i Pjeter Nikes nga Megulla e Pultit.

Udhën e futbollit e ka nisur në Shkodër që kur ishte fëmijë, dhe në shkollën "11 Janari" e zbuloi si talent mësuesi shembullor, Feti Dizdari, i cili ja pati rekomanduar specialistit Ernest Helepianit. Pas përfundimit të 7-vjeçares duke pare talentin e tij e ftoi ekipi i "Fermentimit" të duhanit, pastaj prej aty kaloi tek "Spartaku" i Shkodrës. Në vitin 1953, kur ishte 16 vjeç tekniku Helepiani e bëri pjesë të ekipit të të rijve, me 1954 kaloi tek "Puna" e Shkodrës.

Pas bashkimit të "Punës" dhe "Dinamos" së Shkodrës u rikrijua "Vllaznia". Me 1955-56 luajti me "Vllazninë", te "Puna" e "Vllaznia" gjeti dy idhujt e tij të vjetër, Muhamet Dibra dhe Preke Gjeloshi, shembulli i të cilëve e nxiti të futej me guxim në galerinë e madhe të futbollit shkodrane. Në vitin 1957 u muar nga "Partizani" dhe u vu nën urdhrat e Rexhep Spahiut. Më pas gjithë karrierën e tij brilante nga viti 1956-1971 e bëri për të kuqtë e "Partizanit" si mesfushor i pa lodhur, mushkëria, inteligjenca, magjia e gatimit të fjalës gol tek të kuqtë me yll. Lin Shllaku ka qenë një prej yjeve më të spikatur të futbollit shqiptar, me një karrierë spektakolare, ku në 15-të kampionate Kombëtare ai koleksionoi 7 tituj kampionë, 7 Kupa Republike. Mori Medalje argjendi në turnet ndërkombëtarë Lajpcig e Hanoi. Si kapiten legjendë udhëhoqi legjendën e kuqe në fitoren e Kupës Ballkanike mes klubeve në vitin 1970. Nga viti 1963-1970 ishte titullar dhe kapiten i talentuar kombëtares shqiptare i një plejade të shkëlqyer të vrare nga izolimi politik i kohës. Me ngjyrat kuqezi ka luajtur 13 ndeshje, maksimumin e ndeshjeve të luajtura ndër ato mote. Lini ishte një mesfushor i kompletuar, me përvojë, me qëndrueshmëri, fuqi, teknikë, dhe të klasës, i konsideruar si një nga mesfushorët më të mirë të gjeneratës së tij. (gazetmuesi i talentuar i mitraljerit Pano).

Mendimi, vizioni i shkëlqyer, taktik kontrolli i topit driblingu e gola për fitore e bëri atë një anëtar kyç i "Partizanit" dhe Kombëtares të viteve 60-70-të. Ai ishte i njohur edhe për të shtëna e fuqishme nga distanca dhe fare pak lojtarë, ishin



në gjendje për të replikuar me kalimet e gjata dhe të fuqishme të tij. Edhe pse ishte në thelb një punëtor, inteligjent, kreativ me aftësi dhe disipline të rrebët teknike, ai shquhej edhe në aspektin mbrojtës dhe sulmues të lojës. Shllaku zë vend qendror mes kapitenëve të kobtares shqiptare të gjitha kohërave. Ne pranvere të vitit 1968 ne një ndeshje miqësore te luajtur mes kombëtares Anglisë dhe Evropës. Trajneri i ekipit të Evropës, Helmut Shen e ftoi në përfaqësuesen Evropës, legjionarin kuq e zi, Lin Shllakun, të cilin vete lavdiploti, pas disfatës së Tirane e pati quajtur Kapiteni i madh. Për procedura burokratike - idelogjike bajate të kohës, shqiptari edhe pse ju bë një nderë i tille, nuk mori dot pjesë.

Pasi la futbollin e luajtur ka ushtruar funksionin zv / Trajnerit të "Partizanit" 1972-1973, ndersa në vitet 1973-1974 ka drejtuar "Besëlidhja" e Lezhës; në 1975-1976, përsëri rikthehet te "Partizani", duke drejtuar ekipin shpresa të "Partizanit". Në vitet 1987-1990- ka punuar si mësues edukimit fizik në shkollën ushtarake "Skenderbej". Në vitet 1999-1997 ka emigruar në Greqi duke kryer punë të rëndomta krahu dhe të pa përshtatshme për moshën. Në 70 vjetorin e themelimit

"Klubi i Futbollit - Partizani", Presidenti i Republikës i akordoi titullin "Mjeshtër i Madh", ndërkohë që mbante titullin "Mjeshtër i Merituar" i Sportit. Lin Shllaku nderoi jete me 9 gusht 2016, në moshën 78 vjeçare, pas një sëmundje të

nga qyteti i tij ku lindi. E meritonte dhe e dëshironte një vlerësim nga Shkodra, e meritonte dhe priste një vlerësim nga krahina që mbante mbiemrin e saj, në çeretifikatën e lindjes, në fanellën kuq e zi te nacionales, por edhe në mendje dhe shpirt.

Me vjen keq që as ne, të shoqatës Atdhetare "Dukagjini" të shquar për veprimtari vlerësuese, nuk beri një veprimtari të posaçëm për kampionin e madh, që Dukagjini i dhuroj futbollit shqiptare. Ne, kishim menduar për të përgatitur e zhvilluar një veprimtari vlerësuese për sportiste dhe artistët e shquar dukagjinasi ndër vite, të cilët tashmë e kane nga një CV-i të shkruar tek libri "Dukagjini Yne", vëllimi II e III. Ndiem keq që u hutuam nga rutina e përditshme, nga vrapimi pas gjerave të mëdha siç ishin munometet, apo manifestimet shabllone si "Zëri Vllaznimit". Do duhen 100 a 200 vite, apo ndoshta as një tjetër që Dukagjin t'i dhuroje Kombëtares një kapiten të tillë. Si nuk na shkoj mendja se Kapiteni nuk mund të na priste ne duke shtërzyer he sot he nesër. Çfarëdo veprimtarie përkujtimore që bëjmë, sa do që t'i thërësim e sa do që ta duartrokasim, Kapiteni i

madh nuk do na përgjigjet, as nuk do na buzëqeshi më kurrë. Rastësisht këto ditë pash një dokumentare të promovuar vite më pare në Pallatin Kulturës e tej e të mbushur ne Lushnje, në kujtim të Mjeshtër të shquar Roza Haxhiu. E ndoqa me shumë interes dhe duke ju thënë me dashamirësi, ju lumtë gjithë ideatorëve realizuesve dhe kontributorëve. Nga ana tjetër më pushtoj një pesimizëm për shurlltësinë mospërfillëse shkodrane. Kolegëve të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" po ju kujtoj se "Vjelltas" na iku Lini, vjelltas na iku Leci Shllaku, koha fluturon dhe një dite do mbesim edhe pa Zef Shoshin, Tinka Kurtin (Thanin), Mirash

Vuksanin, Dede Bregun. Ne, Shkodra dhe Shqipëria kemi një ish kampionë Evrope për të cilën po s' qe e mundur këtu edhe atje në Greqi ku ndodhet e meritonte një veprimtari sado modest, pasi modeste janë mundësitë tona.

Ne shqiptaret kujtohem vone kur koha na i rrëmben thesaret. Lini këtu e kishim e nuk e thirrem:- t'i thoshim faleminderit! Lini nuk e kemi këtu në mesin e frymoreve, ai i përket historisë. Lum si ti Lin!

Prele Milani



Anton Grishaj

Një jetë krijuesi plot dinjitet

Të jetosh me librin dhe të përcjellësh jetën estetike të shkrimtarëve të ndryshëm është një jetë më vete: Interesante për nga domethënia estetiko-filozofike, brilante për nga kumti që përcjell dhe po aq sfidante për nga dimensionet dhe objektivat që shkrimtari i vë vetes. E tillë është edhe veprimtaria e mikut tonë, mikut të secilit prej nesh, autorit të librit "Amaneti i pa lënë", ndryshe e poetit Anton Grishaj. Sapo më ra në dorë libri në fjalë i poetit Anton Grishaj, dërguar tek unë përmes mikut të tij poetit Tonin Kaçaj, kureshtja e kritikës më nxiti të fillojë menjëherë nga leximi i tij. Një tufë poezish filluar nga ajo më e thekshmeja, që i jep edhe tonin gjithë përjetimit estetik, "Amaneti i palënë", ku dimensionet e jetës reale të qenies, kësaj radhe sfidohen keqas nga dimensionet e paimagjinueshme të shpirtit, sikur të elektrizon, apo të merr me vete, në atë shkallë që mund ta "takosh" vetëm tek poetët:

"Në mugëtirën e natës

/ Kam parë vetëtimat / Tek skuqnin / E tek shqyenin Qiellin / E s'jam trembur / Atë pasdite në spitalin e Milanos / Ku dhe skutat më të largëta të shpirtit / Më ishin mbushur me trishtim, / I ardhur direkt nga Londra / Më shfaqet portreti i Adit, djalit tim / Oh, biri im!"

shprehet poeti Grishaj tek poezia "Portreti i djalit tim". Dhe malli e dashuria për njerëzit, për jetën e shtyn poetin drejt thellësive të mirënjohjes ndaj atyre pa të cilët jeta e tij mund të rridhte ndoshta krejt ndryshe. Duke iu drejtuar gjyshes së fëmijëve nga e ëma, Drita, poeti vijon: "E re mbeti vejë, / Por djemve dhe vajzave, / Nipërve dhe mbesave / Dësh tua mbledhë vuajtje dhe dhimbje, / Për vete t'i mbante ... Sëmundja ime / Mbase ja dridhi këmbë e dorë, / Po sot do të doja / T'i thoja: / Faleminderit që ke lindur Dritën / Drita, faleminderit që të lindi ty"

Jo rastësisht, përballë këtij shpirti gjithë dhimbje, dashuri dhe respekt për njeriun në përpjekjen time për të ofruar dhe sensibilizuar shokë dhe miq të poetit me rastin e promovimit të këtij libri, u përballa me një dashuri, respekt dhe mirënjohje të paparë, të miqve dhe shokëve të poetit ndaj tij, sa kohë e njohën apo jetuan me të: si shokë fëmijërie, si student në fakultet apo si koleg në gazetari dhe në punë, përgjithësisht, në jetën e tij, aq të gjallë dhe produktive si gazetar, kineast, operator, telekronist apo si shkrimtar. Shok dhome i imi prej rreth 5 vitesh, gjatë periudhës studentore, në vitet akademike 1985-1989, në fakulte-

tin e agronomisë në Universitetin e Kamzës", - na thotë Albin Hiluku, shoku i tij i ngushtë: Dhe, duke ndërjet dëshirën tonë maksimale që të përcjellim gjithçka të mrekullueshme nga kjo njohje dhe miqësi mes tyre, ai vazhdon: "Antoni, djalë i jashtëzakonshëm, kam me të një jetë studentore e në vijim të mrekullueshme, me shumë mirënjohje për të, për lidhjet



tona familjare, për vizitat e ndërjellta tek shtëpia e njëri-tjetrit. Që në shkollën e lartë, edhe pse po mbaronte fakultetin për agronomi, Antoni gjithmonë shkruante, pa pushim: poezi, bejta etj. Atë e njoha që në fillim si njeri me natyrë të hapur, artist i lindur. Fati i solli të ketë shoqe jete, një studente të veterinarisë, Dritën. Dritë e diell është ai çift me dy pëllumbat e vet: Idën dhe Adin", - përfundon gjithë emocionet Albini..

Sapo merr ftesën tonë përmes internetit, miku i Antonit, poeti Vebi Kurtaj, nga Maçesterni më lutet të përcjell në promovimin e librit "Amaneti i pa lënë" fjalë shpirti dhe zemre për Antonin tonë, këtë djalë të veçantë, këtë malësor që na nderon, na thotë Vebiu. Shokët e tij si: Gjovalin Bzheta dhe Tonin Kaçaj gjithë impenjim maksimal për të realizuar në kohë sa me optimale këtë promovim, si një sodisfaksion ndaj autorit të librit, i cili për arsye objektive, nuk arrin të jetë i pranishëm, të befasojnë me dashurinë e respektin për këtë djalë malësor, prej kaq vitesh qytetari dhe intelektual vizionar i një investimi shembullor sa brenda po aq jashtë vendit, filluar me detyrën e telekronistit për M. Madhe, në fundvitet 90-të, pranë RTSH, Tiranë, detyrë që në fillimvitet 2000 do t'i besohet operatorit dhe shkrimtarit malësor, z. Syrja Smajlaj, aktualisht, anëtar i Unionit të

Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë. Numri i atyre që kanë dëshirë të thonë fjalën e tyre të ngrohtë për marrëdhëniet me Antonin dhe kontributin e tij veçanarisht si producent, kineast apo si autor i dhjetra dokumentarëve televiziv është jo i zakonshëm. Rifat Ymeri, kryetar i Unionit të Gazetarëve Profesionistë të Malësisë së Madhe dhe Gëzim Vuçaj, drejtor i revistës "Fjala", sikur rapsodi i mirënjohur Jonuz Delaj, publicisti Ndue Bacaj dhe gazetari sportiv Bashkim Ramekaj të të pestë, njëherish, miq veterane të poetit janë, po aq të gatshëm të të ofrojnë një sërë materiale shi veprimtari të rregjistruara gjatë viteve si

produksione dhe jehonë e veprimtarive të Grishajt, brenda dhe jashtë vendit. Emocionet e ndjeshmërisë gjithë respekt për jetën dhe kontributin e Antonit të shoqërojnë menjëherë sapo njoftohen për këtë veprimtari promovuese, kushtuar librit të kohëve të fundit të Grishajt "Amaneti i pa lënë" edhe shkrimtarët e mirënjohur malësorë si: Dakë Keqaj, Fitore Jonuzi, Mimoza Rexhvelaj, Dashamir Cacaj, Syrja Smajlaj, Isuf Hebjaj, po aq sa edhe sikurse shokë dhe dashamirës të hershëm të Antonit si: Ferit Hasaj, Muhamet Muçaj, Fadil Hasmujaj, Dimitrov Popoviç etj. etj. sikur edhe kryetarët e shoqatave në M. Madhe, si: "Sali Mani", "Malësia e Madhe-Nderi i Kombit" dhe "Malësia e Madhe", me qendër në qytetin e Shkodrës, nën drejtimin respektiv të zotërinjve: Gëzim Vuçaj, Sytki Ndrecaj dhe Imi Kurti.

Atmosfera emocionale e kësaj veprimtarie letrare i kalon kufinj të një promovimi të zakonshëm, ndryshe ka një ngarkesë ndjeshmërie sa artistike, sa humane shumë të lartë, nisur edhe nga fakti që me gjithë dëshirën e madhe, të secilit prej nesh, të jetë i pranishëm në këtë ditë festive, si për cilido krijues, autori i librit, Anton Grishaj, ky i fundit nuk arriti të na e plotësojë këtë dëshirë të përbashkët. Dhe, si për ta lajmëruar këtë moment, ndëshkimi brenda vetes, ai në librin e tij tek poezia "Faji i fundit" do të shprehej gjithë dhimbje shpirti: "Gjithë fajet e botës / E paskan gjetur strehën e tyre / Mbi dhe nën lekuren time"

Megjithatë dashuria për jetën, dashuria si ndjenja më fisnike e qenies njerëzore shpërthen tek poezia "Një mijë e një" duke mbajtur, tek poeti, të gjallë shpresën, besimin për jetën, sikur edhe i freskon shpirtin: "Një mijë e një fjalë i mblodha / Për një këngë / Një mijë e një instrumenta / Për një melodi ... / "Kënga mori dhenë, / kënga ushtoi, / Zoti, / Këngën ma dëgjoi"

Të njëjtat motive dashurie për jetën plazmojnë dimensionet shpirti edhe jete edhe tek poezia, tejet ekspresive, "Larg": "Larg... / Malli kërkoi të më ofrojë, / Por larg, shumë larg / Gishtërinjtë e mi, mës-

uar / Si krehër mbi flokët e tu / Zgjatën / Një qind...një mijë kilometra / ...Gishtërinjtë e mi / Përvluar / Etur / malli për flokët e tu"

"Të jetosh dhe të vdesësh është e njëjta gjë, sepse në të dy rastet do të thotë t'i përkasësh dikujt tjetër. Të jetosh është t'i përkasësh dikujt tjetër së jashtmi, kurse të vdesësh do të thotë t'i përkasësh dikujt tjetër së brendshmi" - thoshte gjiganti Pesuas (Shih librin "Poeti është një shtiracak" fq. 59). Jo rastësore është fakti që Antoni edhe kur i drejtohet jetës, po ashtu edhe kur i drejtohet vdekjes nuk thyhet moralisht, sepse beson te vlerat universale të qenies, siç është vlera e dashurisë së pafundme për jetën, vlerë që vetë krijuesin e bëjnë pjesë të Universit, ndryshe të përjetësisë. Dhe dashuria për jetën, për fjalën si vlerë universale, pasojë e së cilës nga Grishaj sot kemi të botuara tre libra artistikë: "Diku atje shihemi", "Vështroj nga dritarja e asaj nate" si dhe librin që, sot, po promovojmë "Amaneti i pa lënë", tri vëllime poetike mbreselënëse, shumë më tepër se për nivelin artistik, të elektrizojnë së brendshmi për sinqeritetin e shpirtit poetik. Këto, krahas një kontributi shumëdimensional si gazetar televiziv, kineast apo si producent i filmave artistikë, si: "Letra fatale", "Pleqtë e hashashit" si dhe filmi vizatimor "Koha e dashurisë së akrepave", pa haruar produksionin e 37 dokumentarëve televizivë, 21 filmave dokumentarë, si bashkëpunim, me Fondin shqiptar të Zhvillimit, si dhe 6 serive të telenovelës "Familja", një bashkëpunim me RTSH, janë dëshmia më autentike e një producenti tejet të suksesshëm. Jo rastësisht, sot Anton Grishaj gëzon një seri vlerësimesh, si inkurajime serioze të metejshme, për sukseset e tij, siç janë nderimi me:

Çmimin e parë në Festivalin Botëror të Filmit Dokumentar, në Milano, me temë sportive, për filmin, "Lidhëzet e këpucëve", Çmimin e dytë në Festivalin Botëror, në Bjellorusi, për filmin "Bertinus", kushtuar kodikëve të Beratit dhe Çmimin special për nder të jubileut të 20-Vjetorit të Gazetarisë Shqiptare.

Ky është Anton Grishaj, zëri ynë dinjitoz, me dinjitet moral dhe profesional si gazetar, telekronist, kineast, producent dhe krijues, që na mblodhi në këtë ditë promovimi, në qytetin e Koplikut, kryeqendrën e M. Madhe "Nderi i Kombit", si për të na thënë "Nuk e di se sa dhashë në justifikim të vetvetes si pjesë e juaja, por jam shumë i lumtur, që sot u ofrova këtë libër si "Amaneti i pa lënë", ndryshe si vetëdija e obligimit moral dhe profesional, që secili nesh, ka dhe duhet të ketë ndaj kësaj toke, si hapësira e jonë "Nderi i Kombit", ku rriten dhe promovohen, jo thjesht, libra artistikë apo veprimtari të tjera, por ajo më thelbësorja: Shembuj të shkëlqyer solidariteti dhe respektit si ky juaji ndaj meje, një inkurajim optimizmi sui-generis, ndaj birit tuaj: vëllait, mikut dhe kolegut, në stinën e një nevojë shpirtërore maksimale, që ai po ndjen, si kurrë ndonjëherë në jetën e tij, çka ju malësorët e mi e manifestuat kaq mrekullisht në ditën e sotme.

Mirënjohje dhe falënderim ndaj të gjithëve!

Kadri Ujkaj, Kritik letrar

Nënë Tereza - Shqiptarja e shenjtë

JO VETËM 120 MIJË TË PRANISHMIT NË SHESHIN E SHËN PJETRIT, QË ISHIN NGA E GJITHE BOTA, PATJETER TË GJITHË SHQIPTARËT E TË GJITHA HAPESIRAVE TË NACIONALITETIT SHQIPTAR NDIHESHIN KRENARË PËR BASHKËKOMBËSEN E TYRE, QË PO NJIHEJ SI SHENJTËRËSHË. FLAMUJT KUQEZI DHE DËSHMITË PLOT EMOCION FLISNIN PËR LIDHJEN E VEÇANTË QË SHQIPTARËT KANË VENDOSUR, SOT E PËRGJITHMONË, ME NËNË TEREZËN, SHQIPTAREN QË KA GJURMËT E PASHLYESHME NË TIRANË, PRISHTINË, SHKODËR E SHKUP.

Papa Françesku

Shën Tereza pret lutjet tona, jeta e saj një dritë hyjnore mbi të varfrit

VATIKANI SHPALL SHENJTORË NËNË TEREZËN, MESHA E SHENJTË MBAHET EDHE NË SHQIP

Rreth 120 mijë persona, sipas të dhënave nga Vatikani, besimtarë, ndjekës, shqiptarë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe anembanë botës u mbledhën dje në Sheshin e Shën Pjetrit, për të marrë pjesë në ceremoninë e shenjtëritimit të kësaj gruaje me origjinë shqiptare, e cila me veprën e saj bëri që e gjithë bota të fliste për të. Ceremonia, që nisi në orën 10.30, përbën dhe një nga ngjarjet më të rëndësishme për Kishën katolike në këtë vit të Jubileut të Mëshirës. Rreth orës 10.

lë njerëzve të fuqishëm të kohës. "Ajo bëri që zëri i saj të dëgjohej nga të fuqishmit e tokës, që të njihnin fajet e tyre, përballë krimeve, përballë krimeve të varfërisë së krijuar prej vetë atyre", nënvizoi Papa Françesku. E duke ju kthyer dhe një herë veprës së saj ndaj të varfërve dhe të pambrojturve ai theksoi se "mëshira ishte për të krija që i jepet shije çdo veprë, drita që çante errësirën e atyre që nuk kishin as lot për të qarë për varfërinë dhe vuajtjet e tyre. Misioni i saj në periferitë e qyteteve dhe në periferitë ekzistenciale mbetet si një dëshmi elokuede e afërsisë së Zotit me më të varfëritë nga të varfëritë. Sot ja dorëzoj këtë figurë gruaje emblematike të gjithë botës së vullnetarëve. Le të jetë ajo modeli juaj e Shenjtërisë". Nënë Tereza është një figurë aktuale që ka bërë botën të flasë për të dhe veprën e saj. Misionet e motrave të Nënë Terezës janë sot të pranishme në shumë vende të botës duke ndjekur trashëgiminë e

nga çdo ideologji, nga çdo pengesë dhe e shpërndarë mbi të gjithë pa dallime gjuhe, Kulture, race apo feje. Nënë Tereza pëlqente të thoshte "ndoshta nuk flas gjuhën e tyre, por mund të buzëqesh". Le të mbajmë në zemër buzëqeshjen e saj dhe t'ja dhurojmë të gjithë atyre që takojmë rrugës sonë, në veçanti atyre që vuajnë. Do të hapim kështu horizonte shprese shumë njerëzve që ndjehen të humbur dhe që kanë nevojë për mirëkuptim dhe ngrohtësi", u shpreh Papa,

Që prej orëve të para të mëngjesit, ende pa gdhirë, të rinj e të moshuar, burra e gra, persona me aftësi të kufizuara, u mbledhën për të qenë të pranishëm në këtë ngjarje, duke sfiduar edhe temperaturat e larta dhe diellin e fortë. Sheshi ishte mbushur thuajse plot që rreth orës 8.30 me të ardhur jo vetëm nga Italia, por dhe nga shumë vende të tjera. Në fakt, Nënë Tereza, në ndryshim ndoshta nga shumë figura të tjera të shpallur

ishin të pranishëm të paktën 13 kryetarë shtetesh dhe qeverish, ku gjithashtu të shumtë në numër ishin edhe ata të ardhur nga Shqipëria dhe Kosova. Nga Tirana morën pjesë edhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Bujar Nishani; Kryeministri Edi Rama dhe kryetari i PD-së, zoti Lulëzim Basha; Presidenti i Republikës së Kosovës, zoti Ashim Thaçi dhe Kryeministri i saj, Isa Mustafa

PAPA BEKON KOMBET, QË LIDHEN NGUSHTË ME NËNË TEREZËN

Papa Françesku, gjate lutjes së Engjëllit të Tënzot, në Sheshin e Shën Pjetrit në Vatikan I ka bekuar kombet, që lidhen ngushtë me Nënë Terezën. "Të dashur vëllezër e motra, ndërsa po i afrohem përfundimit të këtij kremtimi, dëshiroj t'ju përsërisht e t'ju falënderoj ju



40, Papa Françesku lexoi formulën e shenjtëritimit, duke e shpallur kështu Nënë Terezën shenjtore. Gjatë leximit të omelisë më pas, Papa u ndal në ato vlera që kanë dalluar Nënë Terezën. "Në të gjithë ekzistencën e saj ka qenë bujare e mbartëse të mëshirës hyjnore. Ajo u angazhua në mbrojtje të jetës, u përkul ndaj personave të braktisur, të lënë në prag të vdekjes nëpër rrugë, duke u njohur atyre dinjitetin që Zoti u kishte dhënë", u shpreh Papa ndërsa vuri në dukje forcën dhe ndikimin që Nënë Tereza arriti të ketë edhe përbal-

saj. E pikërisht për këtë, Papa Françesku u shpreh se "ndoshta do ta kemi pak të vështirë ta thërrasim Shën Tereza, shenjtëria e saj është kaq e afërt me ne, kaq e dashur dhe bujare sa që në mënyrë spontane do të vazhdojmë ta thërrasim Nënë Tereza". Dhe duke ju referuar filozofisë së Nënë Terezës mesazhi i Papës sot shkonte përtej atij vetëm fetar. "Kjo punëtorë e palodhur e Mëshirës na ndihmoftë të kuptojmë gjithë më shumë se kriteri i vetëm dhe veprimi ynë i vetëm është të dhurojmë dashuri falas, të lirë



gjithashtu shenjtore, e kishte marrë këtë cilësim që kur ajo ishte gjallë, për shkak të angazhimit të fortë, jo vetëm në Indi, në mbështetje të njerëzve në nevojë, të varfërve dhe të sëmurëve. Ajo është një figurë e njohur në të gjithë botën. Është pikërisht kjo arsyeja, që sot këtu në Vatikan nuk janë vetëm besimtarë katolikë, por njerëz që kanë parë te Nënë Tereza mëshirimin e dashurisë dhe të përkrahjes ndaj atyre që janë dhe më të pambrojtur. Janë me dhjetëra e dhjetëra personat me aftësi të kufizuara që kanë ardhur sot këtu në shesh. Për 1500 vetë, të varfër të cilët trajtohen në shtëpitë e misionareve të Nënë Terezës, e që sot kanë ardhur për të ndjekur ceremoninë e shenjtëritimit të saj, Papa Françesku do të shtrojë një drekë me pica napolitane në një nga mjediset e Vatikanit. Një drekë e cila do të shërbehet nga mbi 200 misionare të Nënë Terezës. Të shumtë në numër dhe shqiptarët, nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia por dhe shumë prej atyre që jetojnë në emigracion. Sot është shumë e lehtë të dëgjosh të flasin në gjuhën shqipe në sheshin Shën Pjetri, sikundër të dallosh shqiptarët nga flamujt me simbolet kombëtare, që ata valëvisin apo mbajnë të hedhur kraheve. Në ceremoninë e sotme

të gjithëve, që morën pjesë. Në mënyrë të posaçme, Misionaret e Misionarët e Bamirësisë, familje shpirtërore e Nënë Terezës. Themeluesja juaj Shenjte ju ruajtët gjithnjë në udhën tuaj e ju nxjerrtë hirin të jeni përherë besnike ndaj Zotit, Kishës, të varfërve. Me mirënjohje plot respekt përsërisht autoritetet e larta të pranishme, posaçërisht ata të vendeve, që lidhen në mënyrë të veçantë me figurën e Shenjtores së Re, si dhe delegacionet zyrtare e shtetëtarët e panumërt, ardhur nga këto vende, në këtë rrethanë të lumtur. Zoti i bekoftë Kombet tuaja! E me dashuri ju përsërisht të gjithë ju, të dashur vullnetarë e veprimtarë të mëshirës. Ia besoj secilin nga ju mbrojtjes së Nënë Terezës: ajo ju mësoftë ta kundroni e ta adhuron çdo ditë Krishtin e Kryqëzuar, për ta njohur e për t'i shërbyer në vëllezërit nevojtarë. E kërkojmë këtë hir edhe për të gjithë ata, që u bashkuan me ne përmes mediave, në të katër anët e botës. Në këtë çast dëshiroj t'ju kujtoj të gjithë ata, që e shkrijnë jetën në shërbim të vëllezërve, në rrethana të vështira e të rrezikshme. Mendoj posaçërisht për shumë Rregulltare, që e dhurojnë pa kursim jetën e tyre. Të lutemi!

Nënë Tereza, tashmë Shën Tereza - model i jashtëzakonshëm për jetën humane

Më 05 Shtator 2016, në ambientet e Institutit të Motrave të Nënë Terezës, stafi i Qendrës Ditore të Shoqatës "Projekti Shpresa" dhe pothuaj gjithë të rinjtë e të rejtat me aftësi ndryshe të Projektit Shpresa u bashkuan me fëmijët, vajzat dhe punonjësit e Institutit të Motrave të Nënë Terezës në Meshën e Shenjtë kushtuar Shenjtërimin të Nënë Terezës, humanistes më të jashtëzakonshme që ka njohur shekulli; një simbol i vlerave të larta humane, i bujarisë, mëshirës, shpirtmadhësisë, flijimit për të tjerët, bashkëvajtjes dhe vënies së interesit të përgjithshëm mbi atë personal.

Ndër të tjera, Padër Rafaeli u shpreh: "Sot e 16 vjet më parë u shua jeta e një qenieje njerëzore me dukje të imët nga trupi, por me një shpirt të madh dhe emër vigan. Ajo ishte Nëna Terezë, Gonxhe Bojaxhiu, murgësja e famshme katolike, Nobelistja e Paqes, në damarët e së cilës gjatë gjithë jetës kishte qarkulluar gjaku shqiptar. E ne sot jemi të bashkuar këtu për t'iu gëzuar këtij lajmi të lumtur: Nënë Tereza, tashmë Shën Tereza."

Vërtet, për besimtarët, vepra e Zotit mbi Tokë. Shërbimi i saj për të varfrit e Kalkutës ishte një simbol i dhembshurisë fetare, i njohur në të gjithë botën. Ajo u vlerësua me Çmimin Nobel për

Paqen. Që në moshë të re ajo kishte ndjerë brenda qenies së saj një thirrje të shenjtë, një urdhër Perëndie, duke u përcaktuar si misionare për vepra bamirësie në shërbim të njerëzimit duke sakrifikuar

valle popullore.

Në vijim, përshëndetja nga të rinjtë dhe të rejtat me aftësi ndryshe dhe stafi përfaqësues i Shoqatës "Projekti Shpresa" konsistoi në recitimin e disa thënieve



vetveten, ajo u shndërrua në Nënë Terezë, duke u bërë nënë e tërë njerëzimit.

Pas përfundimit të Meshës Shenjte, Instituti i Motrave të Nënë Terezës në bashkëpunim me Shoqatën "Projektin Shpresa" paraqitën një program modest i cili kaloi gëzueshëm nën duartrokitjet e të pranishmeve. Vajzat e Institutit të Motrave të Nënë Terezës nën kujdesin e Zj. Adriana Marku, organizatores e veprimtarive, paraqitën një performancë muzikore kushtuar Nënë Terezës dhe

të pavdekshme, nga shprehjet më frymëzuese dhe prekëse të Shën Terezës, si psh:

1. Follu butësisht njerëzve! Tregojë mirësinë në fytyrë, në sy, në buzëqeshjen tënde, në ngrohtësinë e buzëqeshjes tënde, gjithnjë të kesh buzëqeshje gazmore! Jep jo vetëm kujdesin, por edhe zemrën!

2. Ne s'mund të bëjmë dot gjëra të mëdha, vetëm gjëra të vogla me dashuri të madhe.

3. Nëse luksi na rrethon, ne humbim shpirtin. Ne do jemi të aftë të duam të varfrit nëse njohim varfërinë dhe jemi vetë të varfër.

Në përfundim të kësaj performance, në shenjë dashamirësie dhe bashkëpunimi me Institutin e Motrave të Nënë Terezës, nën kujdesin e stafit profesional të Qendrës Ditore, të kryesuar nga psikologjia klinike dhe të miratuar nga Z. Luigj Mila, President i Shoqatës "Projekti Shpresa" u bë e mundur që tu jepej një dhuratë: portreti i Nënë Terezës, tashmë Shën Tereza të punuar me dashuri nga i riu Leonard Marku, dhe korniza e përgatitur me mjeshtëri nga kujdestari social, Kolec Baqli. Portreti iu dorëzua Motrës Superiore të Institutit të Motrave të Nënë Terezës.

Veprimtaria u mbyll me mesazhin: "Mësimet dhe porositë e Nënë Terezës janë një testament i ri për njerëzimin. Ne e kemi modelin e jashtëzakonshëm për të bërë mrekulli; të fillojmë me gjëra

të vogla por që të jenë të mbushura me ndjenjën e mrekullueshme të dashurisë".

Së fundmi mund të lejojmë veten të shprehemi ndjeshëm: Shpirti i Nënë Terezës duhet të udhëheq edhe më tej vizionin tonë për një shoqëri globale të tolerancës, mirëkuptimit, respektit të ndërsjellë dhe solidarizimit pa dallim të përkatësisë sociale, etnike, kulturore dhe fetare. Vetëm në këtë mënyrë mund të kemi ndryshime pozitive sociale në mbarë botën.

Përgatitur nga: Suela NDOJA

Zëri i saj sot, ngrihet lart dhe kërkon mbështetje, përkrahjen e trashëgiminë e vlerës altruiste mes njerëzve

Shpallja e Nënë Terezës shenjte, është një ngjarje e madhe, e cila shkon përtej krenarisë kombëtare dhe fiton vlera universale, si shenjë e himnizimit të së mirës dhe ekzistencës konkrete të humanizmit në shoqërinë e sotme. Një zhvillim i tillë, vjen pikërisht në kohën e duhur, për t'i treguar botës se rruga me e mirë dhe më e drejtë për t'u ndjekur është; ajo e dashurisë. Prandaj shenjtërimi i saj fton qytetarin e sotëm drejt konformizmit, drejt jetës në shoqëri, largimin nga vetë izolimi, përfshirjen në një jetë më aktive, për më shumë bashkëpunim. Kjo ngjarje nuk e kërkon praninë e një syri "të jashtëm", "spektatori vëzhgues". Nënë Tereza ishte njeri i lirë, veprimtaria e saj jetësore, jep shembullin dhe mundësinë

e të kuptuarit të një jete e cila jetohej në liri, e të kuptuarit të vlerës së kohës, e fuqisë së një tingulli a fjale, të peshës së shtrirjes së dorës dhe të vepruarit... Ajo përcjell rreze shprese përmes dëshmisë së saj, se si mund të jetohej jeta në përditshmërinë e saj, në përballimin me duresë e dashuri të vështirësive, çelësin për të jetuar kohën në lumturi. Ashtu si një gonxhe e sapoçele; dhe Gonxhja jonë fton: "e djeshmja iku, e nesërmbja s'ka ardhur. Kemi vetëm të sotmen. Le t'ia fillojmë."

Nëse e ndien rrugën e drejtë, Nënë Tereza bëhet nxitje për vazhdimësinë, apo dhe pikëpyetje e reflektim kur jetojmë minutat tona në pavetëdije, kur mjegulla e indiferentizmit futet në shpirtin njerëzor dhe e transformon krejtësisht qenien. Në këtë formë vjen vlera e saj, si një forcë e ëmbël, që gjën vend për të ndriçuar dhe skutat me të errëta të brendësisë së panjohur. Nënë Tereza bëhet kësaj shtytës për njëriun e sotëm, për të udhëtuar në thellësitë e brendshme, për të lundruar lirisht, pa pengesa duke zbuluar të mirën e cila ish struktur aty më vete dhe lufton me veten, në vend që të pasqyrojë lirisht vetveten. Ky është ndër mesazhet që kjo shenjte përcjell sot, dhe ky shenjtërim



i saj vjen simbolik, sepse shenjtërinë Nënë Tereza e ka fituar gjatë gjithë jetës së saj, në kuptimin e vërtetë të fjalës. Nuk mund të themi që ajo që demonstroi Nënë Tereza është protestim ndaj kësaj shoqërie, apo atyre pasardhëse, sepse ajo që di të bëjë aq mirë është të depërtojë në palcë të problemeve dhe vështirësive, me paqen e brendshme që e karakterizon dhe duresën e pakufinjte.

Ajo tregon rrugën sesi njeriu me besim në thesaret e virtyteve që fshihen në brendësi të tij, mund të jetë i qëndueshëm në vlera, larg tjetërsimeve të vazhdueshme që vijnë si presion grackave që ka jeta dhe së keqes që vazhdimisht tundon; ajo është aty tashmë rreth teje, brenda zërit të ndërgjegjes dhe thotë palodhur: "Jep çka ke më të mirë!"

Nënë Tereza diti më së miri vlerën e "të qenit aty ku je"; prandaj zëri i saj sot, ngrihet lart dhe kërkon mbështetje, përkrahjen e trashëgiminë e vlerës altruiste mes njerëzve.

Danjela Pjetri

Të bashkuar, por jo të barabartë në shenjtërimin e Nënës Terezë!

Nga e mbrëmja e 3 dhe e diela e shenjtë e 4 Shta torit 2016, mijëra shqiptarë nga të gjitha hapësirat shqiptare, mërgimtarët nga shtetet evropiane, nga Amerika dhe gjitha kontinentet "mësynë" kryeqytetin italian, Romën, në sheshin e "Shën Pjetër", pranë Selisë së Shenjtë- Vatikanit, për të shijuar nga afër çastet më kulmore të shenjtërimin të Nënës Terezë. Mërgimtarët nga të gjitha anët, të prirë nga respekti dhe dashuria, krenaria dhe gëzimi, me ngrohtësinë e zemrës dhe shpirtin human, në mënyrë vullnetare pa llogaritur koston e shpenzimeve dhe gjatësinë e rrugës, në mënyrë vetiake dhe të organizuar u nisen drejt Vatikanit, për të qenë prezent në ngjarjen më madhore të këtij shekulli, të papërkrahur me fjalë dhe fotografi, e cila vetëm mund të përjetohet me thellësinë e shpirtit.

"Sot u hap qielli, shqiptarët i dhuruan botës shenjtoren "Shën Tereza". Nuk ka gjë më të çmuar, nuk ka gjë më të bukur, e falënderoj Zotin që më dha mundësinë ta përjetoj këtë madhështi", ishte shprehur një nga mërgimtarët e ardhur nga SHBA-ja e largët, Gjovalin Nik Gjellaj. Ky ishte vetëm një përshkrim i ndjenjës, që mijëra bashkatdhetarë e kanë përjetuar në ditën e 4 Shtatorit në sheshin Shën Pjetër, në Vatikan.

Nënë Tereza me rastin e marrjes së çmimit Nobel, me 11 Shtator 1979, shumë e ndarë për këtë çmim, që në atë kohë ishte në vlerë prej 6 mijë dollarësh, ajo nuk e pranoi për vete, por vendosi t'ua dërgojë të varfërve dhe të sëmurëve të Kalkutës. Po ashtu Nënë Tereza refuzoi edhe darkën e mbrëmjes të organizuar me rastin e çmimit Nobel. Kjo erdhi si shprehje e vlerave humane dhe dashurisë njerëzore që posedonte shenjtëresha e parë shqiptare.

Të nisur nga ky fakt, nuk kemi asnjë deklaram qeveritar apo presidencial, qoftë nga Tirana dhe Prishtina, që të kenë deklaruar: "Shpenzimet e personelit qeveritar, presidencial apo diplomatik pjesëmarrës në këtë ceremoni, ne cemoninone e Shënjtërimin të Nënës Terezës, të jenë përballuar nga xhepi i tyre!" Pra, në qoftë se po, janë përballuar me xhepin e tyre, do duhej të deklaroheshin paraprakisht, para nisjes për në Romë, se do të shkojnë me shpenzimet e tyre pa e dëmtuar buxhetin e shtetit, si shenjtë bamirësie e solidarizimi, duke vendosur që shumë e llogaritur të shpenzimeve nga buxheti i shtetit t'ua ndajnë të varfërve, të sëmurëve për shërim dhe për një të drejtë prone intelektuale më të sigurtë!

Bazuar në numrin e madh të zyrtarëve nga dy shtetet shqiptare, shuma e shpenzimeve të tyre, duke filluar nga shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit dy ditore në Romë, drekat e darkat e shijshme me pijet alkoolike dhe freskuese në hotelet më luksoze të kryeqytetit italian, me siguri arrijnë shifra të larta, jo normale për buxhetin tone. Të paktën, në ditën e shenjtërimin të Nënës Terezë, ditën e ballafaqimit me vlerat hyjnore, ishte dashtë që qeveritarët sikurse bashkatdhetarët të ndjehen të barabartë në të gjitha aspektet, duke i lënë anash privilegjet që ua mundëson pushteti,... ashtu sikurse shqiptarët nga e mbarë bota, që nuk i ndau përkatësia fetare, por i bashkoi krenaria e të qenurit i njëjti gjak që kishte shenjtëresha jonë, e madhja Gonxhe Bojaxhiu-Nënë Tereza.

A ishte gafë vendlindja për Shën Terezën, në dokumentet e Vatikanit?


Disa ditë më parë ju dhe media të tjera botuat lajmin se në dokumentet e shenjtërimin të Nënës Terezës është shënuar vendlindja e saj: Shkup, Shqipëri.

vendit.

Disa media e konsideruan gafë. Po a është e tillë?

Jo. Shën Tereza u lind më 26 gusht 1910, në Shkup (sot Republika e Maqedonisë), atëherë kryeqyteti i Vilajetit

Selia e Shenjtë si qyteti më i madh shqiptar në gadishullin Ilirik, pavarësisht nga ndarjet administrative dhe sajatat politike të kohës, të cilat janë kalimtare, të përkohshme dhe të paqëndrueshme në rrjedhat e historisë.



Këto dokumente të shpërndara nga Selia e Shenjtë janë zyrtare, ndërsa të njëjtën përmbajtje e ka edhe dokumenti me të cilin Nënë Tereza u shpall botërisht për shenjtore, Shën Tereza, pas shenjtërimin të saj, më 4 shtator 2016, në Vatikan.

Përmbajtja e këtyre dokumenteve zyrtare të Selisë së Shenjtë ka nxitur reagime në Shkup, kryeqytetin e sotëm të Maqedonisë, duke pretenduar se ky akt i Selisë së Shenjtë mund të jetë një skandal që duhet të përmirësohet. Por, reagime zyrtare për këtë çështje ende nuk ka, përveç disa reagimeve individuale në rrjetet sociale dhe mediat e

të Kosovës në Perandorinë Osmane. Në kohën kur u krijua Republika e Maqedonisë së sotme, më 1944/45, ajo kishte plot 35 vjet moshë, prandaj, nëse do të shkruhej në dokumentin zyrtar të Selisë së Shenjtë se Nënë Tereza u lind në Maqedoni, kjo do të përbente një të pavërtetë dhe skandal.

Në kohën kur u lind shenjtoria Tereza në Shkup, ky qytet ka qenë me shumicë shqiptare dhe i ka takuar Shqipërisë, si Vilajeti i Kosovës.

Selia e Shenjtë asnjëherë nuk i pranon viset e okupuara si të huaja, siç ishte atëherë Shkupi nën Perandorinë Osmane. Edhe sot, ky qytet njihet nga

Administrata e Selisë së Shenjtë nuk ka bërë asnjë gabim, por e ka përmirësuar një padrejtësi historike ndaj kombit shqiptar. Selia e Shenjtë e din se Nënë Tereza nuk është shenjtoria e parë, as e fundit, që raca shqiptare i fali njerëzimit. Prandaj, kombet që i dhanë botës kaq shenjtore dhe figura me përmasa botërore, nuk guxon të mbetet pre e pushtimeve, falsifikimeve dhe sundimeve barbare, as sot, e as në të ardhmen.

Prof. Dr. Abdulla Mehmeti, Tetovë, shtator 2016, marre nga gazeta "Dita" e dates 07 / 09 / 2016

SHENJTORJA SHQIPTARE



Gëzoju o popull shqiptar
Dhurate të solli shtatori i bardhë
Me zemër bujare të ka ardhë
Vullnesa e Zotit t'ua ka falë
Të shkruem në Altar
Në Altarin e shënjtës kishë
Për nanën e bamirësisë
Moeli i paqes në botë
Me vullnet e besim të fortë
Katër shtatori në përjetësim
Për jetën e vërtetë në lumturim
Shkrue me gërma arit
Në testamentin e Vatikanit
Për vlerë e Shënjtë të idealit
Idealit fetar shpirtëror
Të Shëjtëneshtës kombit tonë
Humaniste e lutjeve e mëshirës

Në shërbim të vuetjeve të vorfënisë
E lindun në shqipen dy krenare
Zoti e kurorzoj të madhe
Në familje muer frymëzim
Baba e nana i dhanë Bekim
Shpirti Shenjt i dha aftësi
Përballoi shumë veshitirësi
Me durim e dashtuni
Simboli i nanës bujare
Me vlera shpirtërore fetare
Shërbej me vullnet e përkushtim
Nuk njofti vuetje as mundim
Me lehtësue vuetje e vorfënim
U ndergjegjesue me shirt e zemër
Në gjithë botën u ba shembull
Me forcën e mëshirës e besimit
Në shërbim të njerëzimit
Pa dallim race e besimit
Në mëshirën Hyjnore, mbylli këtë jetë
Në shpërblim të shenjt, në jetën e vërtetë
Nderim madhështor në Vatikan
Me lutje e respect të madh
Në Shën Pjetër, Perendia e naltësoi
Me shpirtin Shenjt e pagëzoi
Papa shënjtënimin e ligjëroi
Mue shumë vlerë Lumturimi

Jehonë fetare muer Krishtërimi
Si yll drite shkelqej besimi
Natyra ka ligjet e veta
Por e din Zoti kur mbaron jeta
Nanë e Shenjt, nuk vdiqe
Në lumturinë e Hyjit u njite
Në tokën tande ulesh
Gjithmonë me mëshirë lutesh
Madheshtor ishte organizimi
Aty shkelqej festimi
Në kënaqësi shpirtërore njerëzimi
Në përkushtim lutje të forta
Muer pjesë e gjithë bota
Në këtë festë lumturimi
Shqiptarët pa dallim besimi
Mision paqe e mirëkuptimi
Jemi komb i vjetër në Evropë
Të shpërblyem prej të Madhit Zot
Tridhet e tetë Martirë të naltësuem
Nanë Terezën të Shënjtënuem
Shqipëria feston krenare
Botës i dhuruan nanën e madhe

Pjetër Geraj
Bruksel, me 5 shtator 2016

BASHKËBISEDIM RETROSPEKTIVE, ME PAPA GJON PALIN E DYTË

Po ribotojmë bashkëbisedimin gazetarit të shquar Polak, Jas Gavronski, me Papa Gjon Palin të Dytë, mbi idetë, analizat e vizionet e tij për Luftën e Paqën, Bashkimin Evropian, Kapitalizmin, Komunizmin, Rrugën e Tretë si alternativë e zhvillimit të Shoqërisë Njerëzore e të tjerë. Shpresoj që ky bashkëbisedim të konsiderohet i dobishme dhe me interes, edhe tani pas afër një çerek shekulli, veçanërisht në situatën dhe rrethanat e reja sfiduese të krijuara pas largimit të Britanisë së Madhe nga Unioni Evropian, për opinionin publik, lexuesit dhe dashamirësit e shumtë të gazetës "Dukagjini" në Shqipëri e kudo në Botë. Jam gjithashtu i gëzuar që arrita të nxjerrë në dritë nga "Kutia e Memories" një material me vlerë të jashtzakonshme për dje, sot dhe të ardhmen e njerëzimit: Bashkëbisedimin e gazetarit të shquar Polak, me Papa Gjon Pali II-të, e cila fillon me nevojën urgjente të një ndërhyrje humanitare dhe ushtarake ndërkombtare në ish Jugosllavinë e atyre vitëve. / Paraqitur nga Luigj Temali, me 16 shtator 2016

Pozicioni i Selisë së Shenjtë ka qenë gjithnjë në kërkim të ndalimit të luftërave vëllavrasëse.

Atë i Shenjtë, sot ju jeni më popullor se asnjëherë tjetër që kur u ngjitet në fronin pontifical (papnor). Ky është një përfundim disi i pazakontë për dike që ka qenë "pushtet" për 15 vjet. Por kritikata tuaja janë ende për tu dëgjuar, madje edhe në Poloninë "tënde". Pse pikërisht në Poloni?

Është e vertetë se sot në Poloni mas media e disa kompleksiteteve ideologjike të caktuara janë duke u përpjekur ta paraqesin figurën e Papës në një pamje disi të errët. Gjithsesi duhet të nënvizohet strategjia e mjeteve polake të informacionit, që nuk pasqyrojnë ndjenjat e çiltëra të popullsisë katolike si një e tërë. Problemi qëndron për të kuptuar arësytet themelore për këtë orientim kritik. Dhe për mua në bazën e këtij problemi qëndron një koncept i gabuar për të kuptuar çdo të thotë të shkosh drejt Evropës. Unë arrita në këto përfundime për këtë problem gjatë udhëtimit tim të fundit në Poloni më 1991 dhe gjithashtu në disa raste të tjera. Natyrisht unë nuk jam kundër të ashtuquajturit shkuarje të Polonisë drejt Evropës, por jam kundër përpjekjeve për ta bërë këtë përpjekje idhull. Në realitet Polonia nuk ka nevojë të hyjë në Evropë, sepse ajo është tashmë në Evropë, drejt e në qëndrën e saj. Është e rëndësishme që të jetë pjesë e Evropës me vlerat e saj dhe jo duke adoptuar qorrazi zakonet e Perëndimit, jo duke asimiluar të keqen e tyre.

Në një ese që ju shkruat shumë vite më parë "Një kufi për Evropën. Ku?" ju pohoni se kufijtë nuk shtrihen përgjatë tokës, por përgjatë qenieve njerëzore. A është ende ky një opinion i juaj?

Unë do të thosha se kjo është një çështje etike më shumë sesa statistike psh. Kufijtë në tokë duhet domosdoshmërisht të kalojnë përmes parimit të dinjitetit të njeriut dhe lirisë së tij, natyrisht të kuptuara drejt. Megjithatë unë e shkrova këtë ese në një kohë kur komunizmi ekzistonte ende dhe përmbajtja e saj duhet të spjegohet sipas kontekstit.

Cili mendoni ju ka qenë roli juaj në rënien e komunizmit që shumë njerëz, përfshi këtu edhe Les Valesen me të cilin kam folur disa javë më parë, mendojnë se ka qenë vendimtar?

Unë mendoj se në qoftë se ndonjë gjë kishte rol vendimtar, i tillë ishte ai i kristianizmit me doktrinën e tij, me mesazhin e tij moral dhe fetar, me mbrojtjen e tij të qënësishme të humanizmit të njeriut dhe të të drejtave të tij. Dhe unë nuk bëra

asgjë më tepër sesa të kujtoj, të përsëris të këmbëngul se ky parim që duhet respektuar mbi të gjitha parimet e lirisë fetare, por jo vetëm ajo liri, por edhe të gjitha liritë e tjera të njeriut human.

mund të shpjegohet?

Këtu është e rëndësishme të kihen parasysh disa dallime. Nuk është edhe aq një çështje e kthimit të komunizmit sesa një kundërveprim ndaj jo efikasitetit të



Pse komunizmi pati suksesin për të cilin ai lindi në histori dhe si e shpjegoni faktin se ai është ende një forcë për tu marrë parasysh në perëndimin, ndërsa në disa vende të tjera si Lituani, Poloni u kthye në pushtet përmes zgjedhjeve të lira?

Komunizmi ka patur suksesin e tij këtë shekull si kundërveprim ndaj një forme të caktuar kapitalizmi të egër e të papërmbyajtur, të cilin të gjithë e njohin mirë. Gjithashtu duhet marrë parasysh ciklikat shoqërore dhe veçanërisht të parën Rerum Novarum 1893, në të cilën Leo XIII përshkruan kushtet e punëtorëve në atë kohë. Marksi e përshkroi atë gjithashtu në mënyrën e tij. Kjo është se si ishte realiteti shoqëror, pa dyshim dhe ishte dhe një pasojë e sistemit, të parimeve të një kapitalizmi ultraliberal. Dhe kështu reaksioni ndaj këtij realiteti u çua edhe më përpara, u rritë dhe fitoi përkrahjen e shumë njerëzve, jo vetëm Brenda klasës punëtore, por edhe në rradhët e intelektualëve. Shumë prej tyre menduan se komunizmi do të mund të përmirësonte cilësinë e jetës. Në këtë mënyrë shumë intelektualë, edhe në Poloni, u dorëzuan dhe bashkëpunuan me komunizmin. Pastaj, në një pikë të caktuar, ata e kuptuan se realiteti ishte ndryshe nga si e imagjinuan. Disa prej tyre, më trimat e më të drejtët u distancuan nga pushteti dhe kaluan në opozitë.

Dhe ky kthim në pushtet i komunistëve në disa vende ish komuniste si

qeverive të reja, diçka për më tepër nuk vjen si surprizë. Klasa e vjetër në politikë që qëndroi për 50 vjet ishte ajo komuniste. Ata janë të parët që mësuan si ecën politika, si funksionon parlamenti. Dhe të tjerët, ata që sot janë caktuar "si qëndër" ose si e "djathtë" nuk ishin të përgatitur të qeverisnin sepse ata nuk kanë pasur ndonjë mundësi të mëparshme ta bënin këtë. Ata ishin të fortë dhe të bashkuar, në opozitë, në Poloni, në kohën e Solidaritetit, por tani janë ndarë. Në një farë mënyre ky është edhe një huq politik, një lloj atavizmi, një individualizëm i tepruar që çon në fragmentalizëm dhe ndarje në skenën politiko-shoqërore. Forca e tyre qëndron në opozitën dhe jo në idetë konstruktive që të çojnë në qeverisje të sukseshme.

Në Vilnius, në të njëjtin udhëtim në vendet Balltike, ju folët në lidhje me hëndekun mes opozitarëve dhe komunistëve. "Le të mos ketë as fitimtarë as të mposhtur", me kusht që të mposhturit, psh. Komunistët të kujtojnë se ata duhet të lajnë krimet e tyre të shëmtuara dhe të japin shenja të sinqerta të një ndryshimi. Praktikisht a jeni kundër komunistëve të rinovuar?

Po unë e kam thënë atë, ata duhet të ndryshojnë dhe të bien në marrëveshje me të kaluarën. Por është diçka se jo të gjithë prej tyre dëshirojnë ta bëjnë këtë, as në Poloni, as në vendet e tjera.

Unë po ju them sinqerisht se kur iu dëgjova ju të flisni kështu fillon të pyes

veten nëse ju nuk jeni më aq opozitar ndaj kapitalizmit se sa ndaj komunizmit. A asht kjo përshtypja që ju doni të jepni?

Unë do të doja të përsërisja çfarë kam thënë deri tani, që po i përmbledh në disa vargje të një poeti polak Mickiewicz: "Mos dëno një shpatë të verbër, por në vend të saj dorën (që e përdor atë)." Me fjalë të tjera, ne duhet të kthehemi prapë te shkaku i fenomenëve që ne jemi duke dëshmuar (pranuar), jetuar. Dhe, për mendimin tim, në rënjen e shumë problemëve serioze humane e shoqërore që kanë mbërthyer Evropën dhe Botën janë shfaqjet e shtrembëruara të Kapitalizmit.

Natyrisht Kapitalizmi i sotëm nuk është i njëjti me atë të kohës së Leo XIII. Ai ka ndryshuar dhe në masë të madhe nën ndikimin e influencës së ideve socialiste. Kapitalizmi i sotëm është i ndryshëm. Ai ka arritë një bazë sigurie shoqërore në saje të lëvizjeve shoqërore të organizuara, të ligjruara në politikën shoqërore duke krijuar mundësinë që të kontrollohet nga shteti dhe organizatat shoqërore. Megjithatë në disa vende të botës ai ka mbetur në formën e tij të egër, e cila i përket shekullit të kaluar.

Atë i Shenjtë, në çfarë mënyre, qenia e juaj si Papë është e ndikuar nga qenia juaj polake?

Unë u rrita atje, prandaj unë kam marrë me vete historinë, kulturën, eksperiencën dhe gjuhën polake. Madje edhe tani kur më duhet të shkruaj diçka e shkruaj në gjuhën polake. Gjuha e mëmës nuk mund të zëvendësohet. Duke jetuar në një vend iu desh të luftonit për të drejtat e tij, në një vend të zbuluar ndaj agresorit dhe diktaturat e fqinjve të tij. Unë jam udhëhequr gjithmonë nga simpatia për vuajtjet e mëdha të vendësve të botës së tretë, që janë gjithashtu subjekt i një tipi vonësie sidomos asaj ekonomike. Unë kam folur shumë herë për këtë me udhëheqësit afrikan. Kam arritur të kuptoj se çfarë lloj shfrytëzimi është dhe pa mëdyshje kam marrë anën e të varfërve, e jetimëve, të shtypurve, të keqtrajtuarve e të pambrojturve. Njerëzimi jo gjithmonë e dëgjon fjalën e Papës.

Në një kohë ata madje e përcjmojnë atë për qëndrimet e tij ndaj parimeve morale. Ata kërkonin psh. leje për të praktikuar abortin, kontraceptionin, gjëra të cilat një Papë nuk mund ti pranojë sepse Zoti e ka caktuar atë që brez pas brezi të mbrojë humanizmin, dinjitetin e tij dhe të drejtat themelore, në radhë të parë të drejtën për të jetuar.

Njerëzimi me ankth pyesin vetvetën se çfarë lloj Evrope po na pret përpara. A mund ti qetësoni ju ata?

Sot, kujtojmë 105 vjetorin e rënjes së herojt, që lindi në çerdhen e lirisë, Nikë Lekë Pepaj

Për ato që thamë tepër shkurt për Nikë Lekën, në këtë shkrim, aq sa mund të thuhet në një numër gazate, kanë dëshmuar me shumicë dëshmitarë të kohës dhe bashkëluftëtarë të tij, pra nga ata që jetuan deri gjysmën e dytë të shekullit që sapo mbyllëm. Këto dëshmi kolektive përbëjnë një thesar të paçmuar, pasi nuk ka mundur të manipulohet, siç ndodh rëndom nga historian që përfaqësojnë rryma të ndryshme politike. Eshhtë e çuditshme sepse shkrimtarët dhe historianët tanë, të cilët edhe pse të pakët, kanë shkruar fare pak. Mos vallë ata ndryshe nga populli, ishin të manipuluar apo kishin frikë ndonjë censure, nga brenda apo jashtë vendit, që edhe shumë vite më pas thoshte: "duam babën"! duke ëndëruar që Shqipëria të ishte një Anadoll evropian apo një republikë jugosllave etj.? Sigurisht për një shkrimtar apo historian konformist me rryma antikombëtare nuk do të ndihej i qetë duke pasë Nikë Lekën e Kelmendit personazh të veprës së tij. Shqiptarët i kanë dhënë shumë gjeneralë ushtrisë turke, kanë sakrifikuar aq shumë për revolucionin grek, kanë punuar deri edhe për Egjiptin dhe Amerikën, i kanë shtuar popullsinë Turqisë deri më pesë milion e Greqisë një shumë të madhe, pa përmendur diasporat në vendet tjera. Mos vallë katil fermani i historisë ia kishte caktuar këtë të zi popullit shqiptar dhe këtë fat duhet ta pranonin ata si një vendim të Zotit? Gjergj Fishta pari guxim

të shkruante një epike për luftëb e malësorëve e të shqiptarëve në përgjithësi çka edhe bota e quajti të tillë, madje e quajti veprën e tij "Iliada Shqiptare". Po, po ai Homer krijoi edhe një "denx ex machine" për mbret e troje të veta nuk u dhimbet gjaja as jeta".

Nëse ai e bëri si Molicri të "Tartufi" që për të botuar veprën e tij u detyrua të vinte në fund edhe një përfaqësues të mbretit si personazh pozitiv, do të ishte e keqja më e vogël, por në se e bëri për ndonjë arsye tjetër... mos o zot! Për figurën e Nikë Lekës, ai shkroi pak ose aspak. Ndaj për Nikë Lekën heshtja qe shumë e madhe, tepër e dhunshme. Edhe shumë e madhe, tepër e dhunshme. Edhe për Kelmendin gjithashtu...! Ndoshta u mbajt në hije për një kohë të gjatë, sepse ishte edhe politikanë, nuk qe vetëm në prijës apo komandant i thjeshtë. Megjithatë, Nikë Lekën, populli e ka quajtur hero dhe libri i botuar 10 vitet e fundit me titull "Heroi që lindi në çerdhen e lirisë" sqaron shumë problem lidhur me figurën e Nikë Lekë Pepajt.

Vetëm me rastin e 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dikush u kujtua të propozonte për t'i dhënë një decorate, në një kohë kur ai të paktën mbas një shekulli të shpallej ashtu siç e meritonte: Hero i Popullit, sepse e themi me plot bindje e përgjegjesi se e meritonte si askush tjetër... Dhe pastaj ca historian të thonë fjalë me shumë ndrojtje, vetëm

duke cituar të huajt, e veçanerisht ata anglez të cilët kishin qëndruar me javë të tëra pranë Nikë Lekës, në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që nuk e lane në harresë një figure të tillë. Qëndrimi i lënies në hije të figures së Nikë Lekës u duk qartë edhe nga organizatorët e festimit të 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ku nuk u ftua askush nga familja e tij! Nuk do e citoj shkrimet e shumta të famshmes Miss Edith Durham për Kelmendin, Malësinë e Madhe dhe veçanerisht për Nikë Lekën, sepse ato thuhën qartë në librin monografi që kemi shkruar për të dhe që së shpejti do të dale nga shtypi në dy gjuhë: shqip edhe anglisht, por dua të them se ajo bijë e lavdishme e Anglisë, si mbretëresha e Malësorëve, si shkrimtarë, etnografë, historian, korrespondentë lufte, si bamirëse si askush tjetër për malësorët e gjithë shqipëtarët, por dua të theksoj se, Edith Durham u bë shqiptare me zemër e me shpirt por sa vuri këmbën në tokën Shqiptare. Në librin e saj "Brenja e Ballkanit", fq. 250, thotë ndër të tjera: "Kelmendit janë më trima nga të gjithë fiset e tjerë". Kurse për Nikë Lekën, nuk po citoj asgjë prej saj, meqë janë thënë të gjitha në librin monografi me titull "Mbretëresha me zemër e shpirt Shqiptare"...

Interes të veçantë paraqesin shkrimet pak të njohura nga shqiptarët, të pak të njohura nga shqiptarët, të kronikanit, historianit dhe shkrimtarit të madh anglez

Athol Mayhew, i cili së bashku edhe me dy shokë të tij anglez, kanë shkruar shumë për luftrat e malësorëve dhe në veçanti për figurën e Nikë Lekës. Ata kishin qëndruar dhjetë ditë pranë Nikë Lekës më 1878, pra në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kur u kthyen në Angli, ata botuan disa libra e revista si dhe në shtypin e përditshëm duke vendosur edhe fotografinë e Nikë Lekës. Kronikani i njohur E.F. knight thotë ndër të tjera: "Ne mësuam shumë gjëra për forcat e Lidhjes të udhëhequr nga Nikë Leka, nga sa mund të kishim mësuar një muaj ë tërë anketimi në Shkodër, (vini re!). Një ditë bota do të dëgjojë për veprimtarinë e kësaj Lidhje...". Gazetari dhe historian Athol Mayhew shkroi librin e tij të njohur "Në Shqipëri tek Gegët". Para se ta botonte këtë libër, ai bëri edhe mjaft shkrime të tjera në revistat dhe gazetat më prestigjioze angleze. Duke mos u zgatur më shumë me shkrimet e anglezëve, miq të Shqipërisë, po shkruaj shkurtimisht vetëm momentin e përcjelljes së këtyre personaliteteve, mbas qëndrimit të tyre prej më shumë se një jave në shtëpinë e Nikë Lekës, për në Shkodër. "...Vetë Nikë Leka na përcolli për në Shkodër, kurse ne u përpoqëm ta kënaqim në hotel "Tozhli". Ne, - thotë ai, - nuk kishim mish në hell për ta gostitur kryetrimin e Kelmendit dhe komandantin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por, guzhinieri grek i sërviri malësorit trim të tilla të papritura

Një politikan më tha njëherë diçka që më bëri përshtypje. Rënia e murit të Berlinit është mbi të gjitha një problem për në Perëndim, sepse deri tani ky mur na ka mbrojtur dhe mund të jetonim në paqë, të punonim dhe të pasunonim veten tonë pa probleme. Tani na duhet të kujdesemi për të gjithë vendet e Lindjes dhe të shqetësohemi për gjithçka ndodh atje, përndryshe do të na përfshijë edhe ne. Mua mu duk shumë interesant ky koment. Për më tepër këtë e përforcon çdo ditë lufta e Ballkanit. Komuniteti Evropian duke u tërhequr për vete është idiferent dhe i pafuqishëm të gjejë zgjidhje për këtë problem dhe po lejon të vuajnë njerëz të pafajshëm. Dhe kështu, apelet e sinqerta dhe të Selisë së Shenjtë për paqë kanë mbetur si një zë në shkretëtirë.

Çfarë kontributi mund të japin vendet e Evropës lindore në krijimin e një Evrope më të madhe që ju e keni mbështetur gjithmonë?

Mbi të gjitha, kontributi i identitetit të këtyre kombeve. Këto janë kombe evropiane që megjithë këto ndryshime të mëdha që ia ka imponuar regjimi komunist, ia kanë dalë mbanë të ruajnë identitetin e tyre. Ndoshta edhe e kanë forcuar atë falë instiktit të vetëruajtjes. Kjo është e vertetë për Poloninë, por edhe për vendet e tjera të lindjes. Ky identitet shfaqet në mënyra të ndryshme dhe në shkallë të ndryshme. Në thelb në çdo vend është zhvilluar një luftë e vertetë midis internacionalizmit proletar dhe identitetit

kombtar, të cilin ata u përpoqen ta zhduknin. Ata thonin se punëtorët nuk kanë mëmëdhe, sepse mëmëdheu i tij është klasa punëtore. Në fund ishte e qartë se kjo ideologji e klasës, e luftës së klasave dhe e diktaturës së klasës nuk ia doli të shkatronte ndërgjegjen, dimencionet fetare të njeriut. Nga njera anë është Perëndimi i zhvilluar. Por ai është shumë i përqëndruar në çështjet ekonomike. Nga ana tjetër është Evropa ish komuniste, falë vuajtjeve që ka duruar, ende jep prova të një shkalle të vogël supërficialitetit në jetë.

Në vazhden e afrimit midis dy Evropave dhe në të cilin kemi varur shpresat tona, cili prej këtyre dy qëndrimeve duhet marrë më shumë?

Ne duhet të mendohehi thellë se cila prej tyre ka më shumë për të humbur. Unë nuk do të thoja që Evropa Lindore ka më shumë për të humbur, nga pikëpamja e identitetit, se Evropa Lindore është pjekur në sajë të gjithë asaj ekperience të imponuar nga sistemi totalitar.

Falë komunizmit atëherë?

Gati, ai është formuar përmes procesit të vetmbrojtjes dhe lufta kundër totalitarizmit marksist. Në Lindje, një dimension i ndryshëm i shpirtit human u ruajt. Ndoshta, kjo është një nga arsyet pse një Papë polak u zgjodh 15 vjet më parë.

Disa vlera ishin më pak të zhvlehtësuara në Lindje. N.q.s. një njëri tjetër jeton në një sistem që ishte pragmatikisht ateist, madje edhe në një vend si Polonia, del në pah më mire se i çfarë feje është. Ai është

i vetëdijshëm për diçka si kjo, ndërsa në Perëndim nuk janë gjithmonë të vetëdijshëm që Zoti është burim i dinjitetit të njeriut, burim themelor, i vetëm dhe absolut i tij. Një lindor ishte i vetëdijshëm për këtë, edhe një i burgosur në kampet e përqëndrimit ishte i vetëdijshëm për këtë. Në Perëndim, kjo nuk është parë aq qartë nga njeriu. Ai e sheh atë deri në një farë pike. Ndërgjegja e tij, në një farë mase të madhe ka qenë shekullarizuar. Jo rradhë, ai e sheh fenë si diçka që është tjetërsuar.

Ju shpesh flisni rreth figurave të mëdha, themeluesit e mëdhenj të Evropës si: Monet, Shuman, De gasperi. Sot duket nuk ka më lider të atyre dimensioneve. A mund të gjendet një shpjegim?

Unë nuk do të dije se si ta shpjegojë atë, por mendoj se është një çështje vizioni. Politikanët e rinj e kanë ulur veten mjaft, ndërsa nga ana tjetër, vizioni i themeluesve ishte largëpamës, i plotë dhe shumë përmasash. Po konfrontimi me BS i dha atyre një shtytje të fuqishme dhe ata besuan në bashkim, jo vetëm në termat ekonomike e politike, por edhe në ato kulturore e shpirtërore, Sot, kam përshtypjen se gjithçka është reduktuar në dimensionin thjeshtë ekonomik. Në këtë pikë Kisha dhe Papa me ipeshkvit e tij po ballafaqohen me një sfidë dhe detyrë të madhe: mbrojtjen dhe nxitjen e dimensioneve dhe vlerave të tjera, shpesh të harruara. Është një mesazh i kërkuar që jo të gjithë janë përgatitur për ta dëgjuar, madje edhe në mes të atyre që

e dëgjojnë ka që nuk e marrin atë me seriozitet.

Ju iu drejtuar polakëve njëherë: Kërkonit një shteg të pazbuluar. A mos ishte ky një apel në kërkim të një rrugë të tretë mes kapitalizmit dhe socializmit?

Kam frikë se ideja për një rrugë të tretë është një utopi tjetër. Nga njera anë ne kemi komunizmin, një utopi që u vu në praktikë dhe zbuloi vetveten si një e metë tragjike. Nga ana tjetër, ne kemi kapitalizmin që në anën e tij praktike dhe nivelin e parimeve bazë do të ishte i pranueshëm me kufijtë e doktrinës sociale të kishës, se në shumë aspekte ai është konformë me ligjin e natyrës. Kjo është teza e shprehur më parë nga Leo i XIII. Për fat të keq, abuzimet e kësaj praktike të pranueshme nxjerrin në pah forma të ndryshme padrejtësie, shfrytëzimi, dhune dhe arrogance. Dhe kjo është kur ne i përcaktojmë si format e një kapitalizmi të egër. Është zbatimi abuziv i kapitalizmit, që duhet të dënohet.

A mbani ditat, At i Shenjtë?

Jo, kam gjëra të tjera për të menduar dhe për të bërë.

La Stampa 1993 Marrë nga "Athene News", **Jas Gavronski** ka qenë anëtar i Parlamentit Evropian që më 1981. Tani ai punon si gazetar "La Stampa: dhe bashkëpunues i Grupit të Berluskonit për Televizionin. Gazeta Shkodra, e Mërkurë, 17 Nëntor 1993.

gastronomike, saqë Nikë Leka na tha se do ta sillte ndërmend shpesh këtë gosti dhe do të na kujtonte për një kohë të gjatë. Nga ana jonë ne do të mbajmë mend për shumë kohë miqsinë që lidhëm dhe mikpritjen që u tregua ndaj nesh, ndërsa qëndruam mes gegëve në Shqipëri." Nikë Lekë Pepaj dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit

Siç dihet Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte një ndër faqet më të ndritura historinë e lavdishme të luftërave të popullit tone, përpjekja e fuqishme për gjetjen e identitetit kombëtar të dhunuar prej shumë e shumë shekujsh. Lidhja, duke e qënë e tillë, pati jehonë të gjërë, brenda dhe jashtë vendit, u fut në tërë labirinthe e shpirtit të kombit. Në betejën e Cernevalës, Lidhja e Prizrenit u shtyp, por vazhdoi të jetojë në shpirtin dhe zemrën e popullit. Në një këngë të popullit thuhet: "Në Berlin u mbloodh krajlia / Në Stamboll ka shkua Rusia / Bëjnë mbledhi e bëjnë kongare / Me i coputu' tokat shqiptare / Padishai i davletit / Falka tokat ' e mymleqetit / ..."

...
Në gusht të vitit 1878, Porta e Lartë dërgoi marshallin Mehmet Ali Pasha për të shpërndarë Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe për t'u dorëzuar knjazëve malazezë Kelmendin, Hotin, Grudën, Plavën e Gucinë, Pejën e Gjakovën. Marshalli Mehmet Ali Pasha gjeti strehim në sarajat e Abdulla Pashë Drenit, i cili u vu në shërbimin të armiqëve të atdheut. Po ai e pagoi me kokë tradhëtinë, kur pas shumë luftimesh të ashpra, vritet Mehmet Ali Pashë me tërë ushtrinë dhe oficerët që e shoqëronin. Kryengritsit shqiptarë me në krye Nikë Lekë Pepaj, manifestuan hakmarrjen nëpër rrugët e Gjakovës me kokën e prerë të marshallit ndër duar të ngulur në një hu. Pastaj vranë edhe Abdulla Pashë Drenin, vranë dhe prenë të gjithë ushtarët turq në Gjakovë. Kjo ngjarje tregonte se si e priste populli shqiptarë pazarllëqet për copëtimin e trojeve të veta. Në një këngë të jugut thuhet: "Sulltan dëgjo frangjinë / Ne s'e lëshojmë Shqipërinë / Nuk e qasim malezinë / As serbinë as grekërinë / Ne duam autonominë..."

...
Mark Milani, kryekomandant i ushtrisë malazezë, të cilit, pasi iu thyen hundët në betejën e përgjakshme të ura e Rrzharnicës nga malësorët e Kelmendit, Hotit Grudës, Tivarit e Ulqinit, Tuzit etj., të komanduar nga Nikë Leka, tani kaloi për të luftuar në anën tjetër, në Plavë e Guci, Gjakovë etj. Në bazë të vendimeve të Shën Stefanit, Bullgaria do t'i aneksonte vetes rrethet e sotme shqiptare të Korçës, Gostivarit dhe Tetovës. Kurse Serbia do të merrte përkatësisht ato krahinat që i ka patur edhe pretenduar që ti kenë edhe sot në pushtim: Kosovën, Rrafshin e Dukagjinit, e ashtëquajtur Metohi, Preshevën, Bujanovcin, kurse Malin e Zi: Ulqinin, Tivarin, Tuzin, Palvën e Gucinë, Grudë, Kelmendin e Rugovë. Sapo morën dijeni për Traktatin e Shën Stefa-



Nikë Leka i Kelmendit, foto e vitit 1878

nit, shqiptarët lëshuan kushtrimin për të rrëmbyer armët, që të mos lejonin këtë. Ndër individët që u shqua në këtë luftë të ashpër për jetë a vdekje ishte padyshim komandanti i përjetshëm Nikë Leka. Ai ishte bërë tmerr për armikun. Erdhi një moment që armiqët e Shqipërisë, turq apo shqja, nuk bënin dot pa zhdukur Nikë Lekën. Por një punë e tillë ishte me pasojë. Zemërimi i malësorëve do të ishte i papërbajtshëm. Si mund ta linin të gjallë atë që do t'ua zhdukte komandantin? Pabesia u mendua gjatë, bëri plane e ngriti kurthe, derisa u bind se do të kishte sukses. Armiqët e kombit shqiptarë nuk mundën që ta rekrutonin armiq pranë Nikë Lekës, e pikërisht ata që pinin kafe përditë me të. Kështu më 20 Shtator 1911, në një pijetore të qytetit të Gucisë, u arrit komandanti të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, prijësit të madh të kelmendasve e të gjithë malësorëve, t'i hidhet helmi në filxhanin e kafesë, dhe kështu të pushojë përgjithmonë zemra e atij trimi që sjan kanë pushtuar dot as plumbat... Ishte plagosur me dhjetra here, por ai e përsëriti në këmbë... Për këtë here vëtëm dy-tre vargje: " ...Ish aq trim sa i thoshte mendja / Pushka e armikut s'ka plumb Brenda / Skëndërbe kërkon Malësia / Burra të tillë ka prepë Shqipëria. / Kah kur kaloi Nika me shokë / Si rrufeja shkrep në

tokë / Nikë Leka për jetë e mot / Për atëdheun është gjallë dhe sot..."

U vra Gucia, u vra Malësia e Madhe, u vra shumë çështja kombëtare... Populli i Gucisë dhe Shumë të tjerë, e mori kufomën e Nikë Lekës, dorë më dorë, deri sa e shpurën në fshatin e lindjes. Gjashtë orë rrugë. Pas kufomës, populli i Gucisë nuk ishte vëtëm. Lajmi i zi u përhap nëpër tërë vendin. Drejtë Selcës u nisën atdhetarë nga Shkodra, Hoti, Gruda, Tuzi, Shkreli, Kastrati, Gjakova, Peja e Prizreni etj. Në krye të popullit të Malësisë së Madhe qëndronin bashkëluftëtarët e komandantit të madh: Cun Mula, Smajl Martini, Dedë Gjo' Luli, Marash Uci etj.

Pas varrimit me një ceremoni të jashtëzakonshme, pas lamtumirës së fundit, që i lanë trimat, ata u betuan para varrit të Nikë Lekës, se – luftën do ta çojnë deri në fund ashtu si deshe ti...

Por, erdhi një kohë absurd kompromisesh me armiqët, erdhen kohëra të çuditshme, kur kërkohet jo të luftohej për t'u hakmarrë për Nikë Lekën, përkundrazi, për ta harruar sa të jetë e mundur, për ta bërë aq anonym, sa breza të mos dinin fare se kishe pasur një Nikë Lekë...

Kështu e donte politika e "kurvës së motit", kështu u kërkohet pasardhësve të Biss Markut, pasardhësve të Sulltanit, dhe lakejve të tyre në Shqipëri. Po serbo-

malazezët, çfarë thane? Dihet s'ka nevojë për koment...

Do të vinte një kohë absurd që kushdo të bëhej udheheqës i Shqipërisë, duhej të mohonte çështjen kombëtare, duhej të pranohej se Shqipëria gjithmonë kishte qënë vëtëm nga Vermoshi deri në Konispol, ndryshe "Kurva e Motit", ia hiqte karriken e pushtetit. Prandaj kozmopolitët shqiptarë krahas harresës që do të mbillin ndaj Shqipërisë qysh prej Tivarit deri në Prevezë, do të mbillin harresën edhe për ata që luftuan për Shqipëri, duke përfshirë edhe Luftën Antifashiste Nacional çlirimtare të Popullit tonë.

Kush duhej ta pësonte më shumë këtë mynxyrë? Sigurisht Nikë Leka... Dhe lufta për harresën e tij ishte tepër e ashpër dhe e sofistikuar. Ajo nuk bënte gjumë kurrë. Ditë pas dite, muaj pas muaji, vit pas viti, dekadë pas dekate. Harresa nuk harrohet kurrë... Mbas 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, qe paksa liruar rubineti i harresës dhe Nikë Lekës, iu dha një dekoratë nga Kuvendi Popullor me urdhërin "Për veprimtari të lartë patriotike të klasit të parë", por kujtesa edhe atëherë ishte tepër e lodhur dhe cflitur nga goditjet e dekadave nga forcat antishqiptare. Shkollës së mesme të bashkuar Tamarë-Kelmend i qe vënë emrin "Shkolla e Mesme e bashkuar Nikë Leka", kurse për çudi të gjithë popullit, vitin e kaluar, kryetari i komunës me një vendim krejtësisht të jashtëligjshëm dhe jashtë çdo logjike, i heq emrin Nikë Lekës dhe me ndërhyrjen e prindërve, vendosin emrin e një djali njëzetvjeçar, i lindur dhe banues në Amerikë. "Heroizmi" i këtij djaloshi ishte se ky, një natë po kthehej prej një diskoje aksidentohet me makinën e

tij. Nuk ka nevojë për koment! Lexuesi e nxjerr vetë konkluzionin. Kji ishte balta e fundit që hidhej mbi figurën e Nikë Lekë Pepajt... Kushdo e kuoton se sa absurd, i turpshëm dhe tendecioz ishte vendimi i komunës Kelmend. Njerëz të tillë që shiten për një dorë dollarë, nuk kanë fare ndjenjë kombëtare. Deri këu shkon edhe korrupsioni e paturpësia. Për këtë gjest të ulët, u njoftua edhe Prefekti i Shkodrës Gjergj Leqezja dhe problemin e kaloi me një fjalë: "nuk është kompetenca jonë"...! Ndaj me këtë rast, i kërkoja Presidentit të Republikës, që të ndërhyjë me autoritetin e ligjit, duke urdhëruar menjëherë që, shkollës së mesme të bashkuar Tamarë-Kelmend, t'i rivihet emri i heroit që i lindi në çerdhen e lirisë Nikë Lekë Pepaj, me qëllim që të zgjidhet kontradikta e lindur për këtë akt të jashtë ligjshëm të komunës Tamarë nga njëra anë dhe popullit të Kelmendit dhe Malësisë së Madhe nga ana tjetër, për këtë veprim tepër të shëmtuar e skandaloz.

Dr. i shkencave Nikë Bunjaj
Shkrimtar dhe Publicist

*** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi ***



Lulash Brigja

SHPIRTI I POETIT

Si dielli
që ndriçon lulet dhe baltën
Si bleta
që e kërkon kudo mjaltën
Si hëna
që di mijra sekrete
Ashtu është poeti
nuk shkruan për vete.

Si ajri
që i duhet pasanikut e fukarase
Si buka
që mban shpirtin e dynjase
Si uji
që tokës i jep gjelbrim
Ashtu është poeti
na mbush me frymzim.

Si kënga
që nuk këndohet pa fjale
Si deti
që nuk ka kuptim pa vale
Si zemra
që gjithmon na troket
Ashtu edhe njerzimi
s' ka kuptim pa poet.

Si ëndërr
që kurre nuk mbaron
Si ylber
që gjithkush e shikon
Si xhevahir
në fundin e detit
Ashtu
është shpirti i poetit.

APOKALIPS ...

Në këtë fillim
të shekullit të ri
...ku bota të duket e vogël
e shkenca ka bërë magji
Jeta
...s'është veç një lodër

Njeriu...
një milingonë e pavlere
Paraje...
një virus që mbjedh vrer.

Në xixellonjat
e shekullit të kaluar
që nuk pamë kurre ditë
në kafazin pa drite ..
Jemi ..

të parët që na merr era ..
në këtë fillim shekull ...
me klandestine
kamikaz
dhe horror...
ku të pasurit janë xhelat
e të varfërit gladiator.

Në këtë fillim shekull...
ku të "diturit".
i kan humb...
lidhjet imagjinare me Zotin
dhe të uriturit
vdesin në emër të Tij
Toka duket një planet
ku historia
po shkruhet vetëm zi.

Ah brezi im "pilot",
na ra fati...
të jetojmë në një kohe kot .
Ku njeriu është robot
Ku jetën dhe vdekjen
i ndan nje fije e holle...
Ç 'ju desh Adamit
...që e kafshoj atë mollë.

PLAK PA SHKOLLE!

E pyesin nipat plakun.
- Pse rënkon gjysh...çfare ke?
Më duket do iki shpejt...
... se paraja jetën nuk e ble.

Pse po ikin gjysh ...?
...krejt bosh është shtëpia ..
- Po iki jetash më mire ...

se krejt asht prish njerzia.

Kur djemt se duan këtë vend
as unë se dua këtë jete ..!
Punova e vuajta gjithmone..
por asgja marak s'po më mbet ..
Kullën e gurit e lshova...
po vdes në një shpi me qera ..
Tokat e mija i lanë djrrre...
e kërkush nuk del , as me i pa.

Tana të mirat po i kam...
por mua s'më pëlqen kurrja
Ka humb dashtina e besa
burra ...e shoqni s'ka ma.

Të gjithë jetojn me maska...
rrugët me mejhana jan mbush
Punën se don asnjëni...
e marrja ka dal për fushë.

Të keqit i thojnë, i forte ...!
... e të mirit i thojnë, qyqar...!
Shumica kan ik nepër bote
kan turp me than ...- Jam shqiptar.

Mos ik gjysh . Mos ik ...
se ndoshta do bëhet më mire ...
-- Uroj të bëhet për Ju...
por.
më duket e vështire.

MEDITIM....

Ajo që ndodhi shekuj më parë...
më shumë së kurrë
tani po besohet ...
Në kryq gozhdohet
Krishti i pa faj?
ndërsa Baraba katil lirohet?
Ahh sa makaber darka e fundit ..
heshtin disa ,
... por puth tradhtari...
Të puthin ,të vrasin
...lindja dhe perendimi
Se plot me Juda...
u mbush njerzimi.

Pas dymije vitesh.
nuk është legjendë
... por vjen e gjalle , vjen si reale ...
Ku njerzit vriten si kasaphane...
shkaqet
preteskstat
krejt... krejt banale
Në emër të Allahut
..në emër të ligjit
për pak pushtet
për shumë flori ?
Gjithmon kjo tokë u la me gjak ..
nga egërsirat , djalli njeri..
Ata,që vdesin për Muhametin.
.si kamikaz e djegin vetin
s'jan besimtar .
por djalli vete?
Sinjal i forte se paqe s'do ketë?

O Zot i madh që krijove njerin.
e mbi këtë toke .
... i dhe pushtet
Me miresin tënde na fal pak paqe,
se ç'ka po bëjnë ,
..... se dine as vete!



Ndue Mici

LUFTA E REÇIT

Reçi i luftës, Reçi i penës
dhe i pushkës!

U hap lajmi në malësi
Se Reçin e sulmoi fashizmi i zi.

Kur lajmi u hap an e man,
E tan Malësia u çue në kam
Rroku armët e në luftë u rreshtue
Në krah të trimave partizanë me luftue

Luftohej shpi më shpi
Në prita e llogore
Ishte luftë marëpopullore.

Luftohej me trimni, si askun tjetër
Në ledhe, në male, në kodër
Në këtë përleshje për jetë a vdekje
Ra heroikisht një vajzë e vogël.

Ajo u flijue për lirinë e popullit
E të gjithë Shqipnisë
Ajo ishte bija e Bejto Fasllisë!

Ajo dha jetën e saj të re
Për Atdhe e Liri.
U ba dëshmore e parë në veri.

Bejto Fasllia ishte luftëtar
Trim e burrë me nam
Ai luftoi si burrat
Përkrah trimave partizanë.

Luftoi Reçi, luftoi Malësia
Luftoi Shkodra e tan Shqipnia
Deri sa në Nëntor u arrit liria!

Për këtë liri Njëzet e tetë mijë Dëshmorë
Jetën e dhanë.
Në luftën për liri me armë në dorë
Ata ranë.

Ranë për të mos u harruar
Në altarin e kombit yje të pushuar!

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION Kimay
Produzione Giacche

